



# Sfidat dhe Mundësitë për Punësimin e Grupeve të Marxhinalizuara nga NDËRMARRJET SOCIALE



**2016**




**Sfidat dhe Mundësitë**  
**për Punësimin e Grupeve**  
**të Marxhinalizuara nga**  
**NDËRMARRJET SOCIALE**

© *Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim*

*Tiranë, Shqipëri, 2016*

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim  
Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia  
Bashkiake 5,  
Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,  
Kutia Postare (PO Box) 2418/1  
Tel. 04 2254881 Faks: 04 2254883  
Email: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)  
<http://www.partnersalbania.org>




# Sfidat dhe Mundësitë për Punësimin e Grupeve të Marxhinalizuara nga NDËRMARRJET SOCIALE



**2016**

*PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM*



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra



UNIVERSITÉ DE FRIBOURG  
UNIVERSITÄT FREIBURG



PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



Ky studim u realizua nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim nëpërmjet Programit Rajonal për Promovimin e Kërkimit (RRPP) në vendet e Ballkanit Perëndimor. Programi financohet tërësisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Departamenti Federal i Punëve të Jashtme.

#### **Për realizimin e studimit punuan:**

##### **Grupi i Vëzhgimit**

**Adela Bani  
Maris Selamaj  
Kostandina Keruti**

##### **Grupi i Administrimit të të dhënave**

**Elona Kapexhiu  
Erla Haska**

##### **Grupi i Analizimit të të dhënave dhe Hartimit të Raportit**

**Ariola Agolli  
Erla Haska  
Klotilda Kosta**

#### **DISCLAIMER**

Programi RRPP promovon studimet në shkencat sociale në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Serbi). Kërkimi në shkencat sociale ndihmon në kuptimin e nevojave specifike për reforma të vendeve në rajon dhe në identifikimin e implikimeve afatgjata në zgjedhjet e politikave. Studiuesit marrin mbështetje përmes granteve për kërkim shkencor, trajnimeve tematike dhe metodologjike, mundësi për rrjetëzim rajonal dhe ndërkombëtar si dhe mentorim. Programi RRPP koordinohet dhe zbatohet nga Instituti i Fakulteteve për Europën Qëndrore dhe Lindore (IICEE) në Universitetin e Fribourg (Zvicër). Programi financohet tërësisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Departamenti Federal i Punëve të Jashtme. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht opinionet e SDC dhe Universitetit të Fribourg.

**Dizajni grafik:** Arben Hamzallari

**Printimi:** SHTEPIA BOTUESE  
**mediaprint**

# tabela

## e PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive.....	8
Hyrje .....	10
Qëllimi i studimit.....	10
Rëndësia e studimit .....	11
Përshkrimi i problemit .....	12
Papunësia .....	12
Grupet e marxhinalizuara.....	12
Grupet e marxhinalizuara dhe pozicioni .....	13
i tyre në tregun e punës.....	13
Masa aktive për integrimin në punë të grupeve të marxhinalizuara .....	15
Roli i Modelit të Integritimit në punë në Shqipëri .....	16
Pyetjet Kërkimore .....	17
Struktura e studimit.....	17

### **Kapitulli 1**

<b>Vështrim literature .....</b>	<b>18</b>
Shkollat kryesore të mendimit mbi Ndërmarrjet Sociale .....	18
Kuadri ligjor i ndërmarrjeve sociale në shtete të ndryshme .....	20
Integrimi në punë si një fushë e rëndësishme aktiviteti për ndërmarrjet sociale .....	21

### **Kapitulli 2**

<b>Konteksti Shqiptar .....</b>	<b>23</b>
Tranzicioni politik.....	23
Performanca ekonomike .....	24
Njohja e kontekstit dhe konceptit të NSve .....	25
Prespektiva historike e NSve .....	25
Kuadri ligjor dhe institucional i NSve .....	26
Modelet e ndërmarrjeve sociale .....	27
Incentivat financiarë dhe mekanizmat mbështetës .....	28



### **Kapitulli 3**

**Metodologjia**..... 31

Instrumentat e përdorur ..... 32

Përzgjedhja e kampionit ..... 33

Kufizimet e studimit dhe nevoja për kërkime të mëtejshme ..... 33

### **Kapitulli 4**

**Gjetjet** ..... 35

Gjetjet mbi ndërmarrjet sociale ..... 35

Identiteti i përgjithshëm i ndërmarrjeve sociale (NSTë) ..... 35

Lloji i veprimtarisë dhe misioni ..... 39

Qeverisja dhe struktura e pronësisë ..... 44

Struktura financiare e NSve ..... 46

Punësimi i personave nga grupet e marxhinalizuara në NS ..... 54

Gjetjet mbi personat e papunë nga grupet e marxhinalizuara..... 56

Të dhënat demografike ..... 56

Punësimi ..... 58

Kushtet e jetesës..... 62

Përfitimet sociale ..... 63

### **Kapitulli 5**

**Diskutim dhe Konkluzione**..... 66

Profili i ndërmarrjeve sociale ..... 66

Situata e grupeve të marxhinalizuara ..... 69

Mundësitë për punësimin e grupeve të marxhinalizuara nga NSTë..... 71

Sfidat për punësimin e grupeve të marxhinalizuara nga NSTë ..... 72

### **Kapitulli 6**

**Rekomandime** ..... 74

**Referenca**..... 76

# Lista

## e SHKURTIMEVE

- AVSI** - Association of Volunteers in International Service
- BKTF** - United for Child Care and Protection
- COSPE** - Cooperation for the Development of Emerging Countries
- FSHNS** - Forumi Shqiptar i Ndërmarrjeve Sociale
- IB** - Inkubator Biznesi
- ICSEM** - International Comparative Social Enterprise Models
- IPARD** - EU Instrument for Pre-Accession Assistance in Rural Development
- LIS** - Laboratori i Inovacionit Social
- NS** - Ndërmarrje Sociale
- OJF** - Organizata Jofitimprurëse
- P2P** - People to People
- SHKK** - Shoqata Kursim Krediti
- USHKK** - Unioni Shqiptar i Kursim Kreditit
- VET** - Vocational Education and Training



## Përmbledhje ekzekutive

Ekonomia sociale dhe në veçanti ndërmarrjet sociale kanë një kontribut të rëndësishëm në ekonomi. Ekzistojnë rreth 2 milion ndërmarrje sociale në Europë, që përbëjnë 10% të gjithë bizneseve në Bashkimin Europian. Më shumë se 11 milion njerëz, ose afërsisht 6% të punonjësve në BE punojnë për ndërmarrje sociale (European Commission, 2016). Në të vërtetë, papunësia e madhe strukturore midis disa grupeve, limitimet që vijnë nga politikat tradicionale të tregut të punës, si dhe nevoja për më shumë politika integruese të reja dhe aktive ka ngritur pyetje lidhur me rolin që ndërmarrjet sociale mund të luajnë në reduktimin e papunësisë dhe rritjen ekonomike. Krijimi i vendeve të reja të punës nga ndërmarrjet sociale kontribuon në integrimin e grupeve të ndryshme në tregun e punës, veçanërisht grupeve të pafavorizuara. Grupe të ndryshme të marxhinalizuara janë lënë jashtë vëmendjes dhe tregut të punës dhe janë bërë shumë të varur nga ndihma ekonomike. Ndërmarrjet sociale janë parë si një model për reduktimin e varfërisë dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës (UNDP, 2008). Edhe pse në rajonin e Ballkanit Perëndimor zhvillimi i ndërmarrjeve sociale është në fillimet e tij, ndërmarrjet sociale janë konsideruar si modele efektive potenciale për t'i dhënë një zgjidhje problemeve sociale që shoqërojnë grupet e marxhinalizuara në shoqëri (Varga & Villanyi, 2011).

Studimi "Sfidat dhe mundësitë për punësimin e grupeve të marxhinalizuara nga ndërmarrjet sociale" ofron një qasje deskriptive dhe eksploruese të tipologjisë dhe modeleve të ndërmarrjeve sociale me qëllim kuptimin nëse modeli i integritit në punë mund të japë rezultate në Shqipëri. Studimi u krye në tre faza: faza e parë - kërkim i raporteve të ndryshme të realizuara mbi ndërmarrjet sociale dhe grupet e marxhinalizuara; faza e dytë - intervista ballë për ballë me 30 përfaqësues nga ndërmarrjet sociale duke përdorur metodologjinë ICSEM; faza e tretë - intervista ballë për ballë me 74 persona të papunë nga grupet e marxhinalizuara, duke përdorur një pyetësor gjysëm të stukturuar.

Profili i NSve është bazuar në 4 dimensionet: 1) identiteti i përgjithshëm; 2) natyra e misionit social; 3) struktura e pronësisë & qeverisja; dhe 4) struktura financiare. Ndërmarrjet sociale janë një fenomen i ri në tregun shqiptar dhe janë ende në fazën e rritjes e parë nga prespektiva e ciklit të jetës organizative. Disa ndërmarrje sociale të themeluara në Shqipëri veprojnë në sektorë të ndryshëm dhe janë të regjistruara me statuse ligjore të ndryshme. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e NSve janë regjistruar si: *OJF, person fizik, shoqëri të kursim kreditit dhe shoqëri të bashkëpunimit reciprok*. Gjetjet tregojnë një nivel të ulët të kapacitetit dhe qëndrueshmërisë përsa i përket kapaciteteve financiare dhe fuqisë punëtore në ndërmarrjet sociale, por me tendencë rritje në vitet e ardhshme.

Gjetjet e bazuara në intervistat me persona të papunë nga disa grupe të marxhinalizuara identifikuan një nevojë të menjëhershme për punësim,



shoqëruar një dëshirë konkrete për t'u punësuar. Pjesa më e madhe e personave të papunë janë të pakualifikuar dhe nuk arrijnë të kuptojnë procesin e trajnimit dhe përfitimet e tij para hyrjes në tregun e punës. Pavarësisht disa fakteve që tregojnë një potencial në rritje të ndërmarrjeve sociale për të punësuar grupe të marxhinalizuara, ka përsëri pengesa që e vështirësojnë këtë proces.

Qeveria e Shqipërisë ka marrë së fundmi një sërë hapash përsa i përket hartimit të kuadrit ligjor për ndërmarrjet sociale, sipas projektligjit, ndërmarrjet sociale mund të jenë *vetëm organizata jo fitimprurëse*. Kështu projektligji përjashton format e tjera të ndërmarrjeve sociale të krijuara në Shqipëri dhe fokusohet vetëm në modelin e integritit në punë, me qëllim përfshirjen e grupeve të marxhinalizuara. Duke iu referuar kryesisht kuadrit ligjor dhe eksperiencës së vendeve të tjera të botës si dhe bazuar në gjetjet e këtij studimi, në këtë raport do të jepen disa rekomandime mbi çështjen në fjalë.

Së pari, duke konsideruar që ndërmarrjet sociale janë në fazën e parë të zhvillimit, Shqipëria mund të konsiderojë një model legjislativ të hapur, më tepër sesa një ligj specifik mbi ndërmarrjet sociale. Kuadri rregullues duhet të adresojë natyrën e aktiviteteve dhe qëllimeve organizative, më shumë sesa formatet institucionale nën të cilat ato punojnë. Kjo i mundëson ndërmarrjeve sociale të zgjedhin modelin më të mirë ose statusin ligjor që i përshtatet më shumë nevojave dhe misionit të tyre social. Zhvillimi dhe roli i NSve nuk duhet të qëndrojë në mënyrë strikte brenda linjës së përfshirjes sociale dhe integritit në punë. Ndërmarrje sociale duhet të konsiderohen ato ndërmarrje që veprojnë në një spektër të gjerë shërbimesh dhe tregtie, si një mënyrë për të nxitur inovacionin social. Kjo mbështetet dhe nga rezultatet e studimit, të cilat tregojnë se ka modele të ndryshme NSsh, bazuar në statusin ligjor si dhe në strukturën e pronësisë dhe qeverisjes.

Së dyti, organizatat e shoqërisë civile, ndërmarrjet sociale, ekspertët, dhe qeveria duhet të kenë një rol më aktiv në promovimin e ndërmarrjeve sociale dhe kontributit të tyre në ekonomi.

Së treti, organizatat e shoqërisë civile, institucionet ndërkombëtare, donatorët dhe qeveria duhet të krijojnë programe zhvillimore për të forcuar kapacitetet e NSve, të krijojnë mundësi që të merren njohuri rreth modeleve të zhvillimit të biznesit, dhe të mësohet veçanërisht rreth praktikave të suksesshme lokale dhe ndërkombëtare të NSve. Nga ana tjetër, qeveria dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të zhvillojnë programe të përshtatshme trajnimi për grupet e marxhinalizuara, me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës dhe përfshirjen sociale. Programet e trajnimit duhet të zhvillohen në përputhje me nevojat specifike dhe të marrin në konsideratë periudhat e gjata të papunësisë.

Së katërti, qeveria duhet të alokojë grante specifike dhe të zhvillojë skemat e huave të buta duke marrë në konsideratë statuset e NSve dhe grupet përfitues. Kjo duhet të shoqërohet me incentivat përkatëse fiskale dhe subvencionet sipas statusit ligjor respektiv. Ligji i prokurimit publik duhet të rishikohet, duke amenduar kërkesat e prokurimit të përgjithshëm publik me qëllim mundësimin e përfitimit të kontratave publike nga ana e NSve për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.



## Hyrje

Pas krizës financiare të vitit 2008, studimet shkencore u fokusuan në kërkimin e formave inovatore të aktivitetit ekonomik që shkojnë përtej “kompanive të zakonshme të biznesit” në përpjekjen për të propozuar modele rigjeneruese me qëllim daljen e menjëhershme nga kriza. Gjetja e modeleve alternative për rritje ekonomike dhe punësim ishte më e evidente dhe e rëndësishme për vendet e Europës Juglindore që janë përballur me kosto sociale dhe ekonomike të mëdha, me norma të larta papunësie (sidomos midis grupeve të ndryshme të marxhinalizuara të lënë jashtë vëmendjes dhe tregut të punës dhe shumë të varur nga ndihma ekonomike), që prej tranzicionit të viteve '90. Në këto rrethana, ndërmarrjet sociale janë parë si një model për reduktimin e varfërisë dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës (UNDP, 2008).

Në veçanti, ndërmarrjet sociale janë përkufizuar si një model i përshtatshëm për integrimin e grupeve të marxhinalizuara në tregun e punës (Nyssens & Defourny, 2013). Edhe pse në rajonin e Ballkanit Perëndimor zhvillimi i ndërmarrjeve sociale është në fillimet e tij, ndërmarrjet sociale janë konsideruar si modele efektive potenciale për t'i dhënë një zgjidhje problemeve sociale që shoqërojnë grupet e marxhinalizuara në shoqëri (Varga & Villanyi, 2011).

Nga ana tjetër, kjo është një fushë relativisht e re studimi në literaturën shkencore dhe ka teori të ndryshme që përpiqen ta trajtojnë këtë çështje. Grupi i parë i teorive i trajton ndërmarrjet sociale kryesisht si një mjet për sigurimin e qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile dhe kuptimin e punës së tyre brenda ekonomisë së tregut. Brenda këtij koncepti teorik pjesa më e madhe fokusohet në organizatat jofitimprurëse dhe përpjekjet e tyre për të diversifikuar fondet dhe burimet e të ardhurave.

Qasja e dytë teorike e zhvilluar zgjeroi konceptin duke përfshirë sipërmarrjen sociale, organizatat jofitimprurëse dhe çdo ndërmarrje me mision social (Dees, 2011; Dart, 2004; Nicholls, 2006; Austin, Stevenson, & Wei-Skillern, 2006). Diferenca kryesore midis dy qasjeve teorike është se e dyta fokusohet te rezultatet dhe përfshin modele të ndryshme ndërmarrjesh që kanë mision dhe qëllim social.

## QËLLIMI I STUDIMIT

Ky studim ka për qëllim përshkrimin dhe identifikimin e mundësive dhe sfidave për punësim të grupeve të marxhinalizuara nga ndërmarrjet sociale në Shqipëri.

Për të arritur qëllimin kryesor të studimit, së pari u zhvillua një hartëzim i të gjitha modeleve të ndërmarrjeve sociale që veprojnë në Shqipëri, me qëllim identifikimin, klasifikimin si edhe analizimin e procesit të institucionalizimit brenda të cilit veprojnë këto NS duke përdorur metodologjinë dhe instrumentin e ICSEM<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Projekti “Modelet Krahasimore Ndërkombëtare të Ndërmarrjeve Sociale” (International Comparative Social Enterprise Models - ICSEM) (2013-2017) ka për qëllim ndërtimin e njohurive rreth modeleve të Ndërmarrjeve Sociale të sapo krijuara apo të konsoliduara në treg kudo në botë, duke ndjekur udhëzues të përbashkët me qëllim zhvillimin e analizave krahasuese ndërkombëtare. Objektivat e

Pjesa e dytë e studimit konsiston në analizën e një kampioni të përzgjedhur individësh, përfaqësues të grupeve të marxhinalizuara, me qëllim hulumtimin e thelluar në problemet e jetës së përditshme të këtyre individëve dhe veçanërisht mbi çështjen e papunësisë së tyre.

Duke pasur parasysh qëllimin e përgjithshëm të këtij studimi, pjesa e fundit konsiston në një eksplorim më të thelluar mbi ndërmarrjet sociale, për të kuptuar nëse këto ndërmarrje mund të shërbejnë si një model për integrimin e grupeve të marxhinalizuara duke analizuar njëkohësisht sfidat që ndërmarrjet sociale hasin dhe mundësitë që ofrojnë këto ndërmarrje sociale në tregun e punës.

## RËNDËSIA E STUDIMIT

Ky studim ka një kontribut praktik në eksplorimin e mëtejshëm të një fushe në zhvillim e sipër si “ndërmarrja sociale”. Kontributi i parë qëndron në ndërtimin e një baze të dhënash apo harte të ndërmarrjeve sociale që veprojnë në Shqipëri duke analizuar identitetin e tyre, modelin e qeverisjes si dhe strukturën financiare.

Së dyti, studimi paraqet një panoramë të grupeve të marxhinalizuara në Shqipëri. Normat e papunësisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të jenë të larta dhe veçanërisht Shqipëria ka një normë papunësie rreth 1,9% (INSTAT, 2015). Për rrjedhojë, tregu i punës është pamjaftueshëm për grupet e marxhinalizuara (si psh. gratë, të rinjtë, minoritetet etnike dhe banorët e zonave rurale), krahasuar me normën e lartë të papunësisë, normat e ulëta të pjesëmarrjes dhe përfshirjen e madhe në aktivitete informale. Duke njohur këtë situatë, studimi kontribuon në një analizë më të detajuar të situatës së grupeve të marxhinalizuara në Shqipëri. Meqenëse ka shumë pak të dhëna zyrtare të publikuara mbi grupet e marxhinalizuara, gjetjet e këtij studimi japin një informacion cilësor të vlefshëm për të gjitha grupet e interesit dhe publikun.

Në veçanti, ky studim siguron informacion më të gjerë mbi përfshirjen e grupeve të marxhinalizuara në ndërmarrjet sociale, të cilat përbëjnë një model potencial të integritimit në punë. Ky model do të ndihmojë në transferimin e grupeve të marxhinalizuara nga individë pasivë të popullsisë dhe marrës të ndihmës sociale në një pjesë aktive në tregun e punës, pa anashkaluar barrierat me të cilat ata do të përballen.

Nga ana tjetër, politikat në rajon për integrimin në shoqëri bazohen në modelet e BE-së (shpesh të kopjuara), pa një analizë të mjedisit dhe kushteve lokale apo nevojave të grupeve lokale të interesit. Për këtë arsye, gjetjet e këtij studimi do të shërbejnë për të advokuar dhe kontribuar drejt zhvillimit të politikave publike në të dyja fushat: zhvillimin e ndërmarrjeve sociale dhe integrimin në punë të grupeve të marxhinalizuara.

projektin ICSEM janë: 1) Identifikimi dhe karakterizimi i modeleve kryesore të ndërmarrjeve sociale; 2) Analiza e marrdhënieve/ngjashmërive midis këtyre modeleve dhe nxitësit kryesorë të jashtëm apo forcat mbështetëse që udhëheqin këto modele; 3) Shqyrtimi i roleve specifike dhe kontributeve.

Për informacion të mëtejshëm mbi projektin ICSEM, ju lutem vizitoni linkun:

<http://www.iapsoцент.be/content>



## **PËRSHKRIMI I PROBLEMIT**

### **Papunësia**

Forca e punës ka regjistruar rënie gjatë viteve të fundit, me një rritje të normës së papunësisë për grupmoshën 15-64 vjeç nga 13% në 2008 (INSTAT, 2008) në 17.8% në 2014 dhe me një rënie të pjesëmarrjes së të rinjve në forcën e punës (INSTAT, 2015). Norma e papunësisë është më e lartë krahasuar me normën mesatare historike, duke reflektuar një mospërputhje midis ofertës dhe kërkesës në tregun e punës. Në vitin 2014, numri i të papunëve në Shqipëri rezultoi në 219,797 persona (INSTAT, 2015).

Norma e papunësisë së të rinjve në 2014 ishte 32.5% (35.6% për meshkujt dhe 27.4% për femrat). Krahasuar me vitin paraardhës, norma e papunësisë së të rinjve është rritur me 5.3% dhe veçanërisht femrat e reja janë më pak të përfaqësuara në tregun e punës. Përsa i përket nivelit arsimor, norma e papunësisë është më e madhe tek personat me arsim të mesëm (21.3%) për vitin 2014, ndjekur nga ata me arsim të lartë (17.2%) (INSTAT, 2015).

Sektorët kryesorë të punësimit janë bujqësia, tregtia dhe administrata publike. Edhe pse ka një përqindje të lartë të individëve të vetëpunësuar në bujqësi, të cilët konsiderohen të punësuar, zonat rurale vazhdojnë të mbeten zonat më të varfra në vend (UNDP, 2013).

Tregu i punës në zonat rurale është një territor disi i panjohur që përballlet me sfida të konsiderueshme krahasuar me zonat urbane. Zonat rurale kanë qenë kryesisht të karakterizuara nga një forcë pune me aftësi të pakta, mundësi të kufizuara, e mbështetur kryesisht tek bujqësia si mjet jetese dhe niveli i lartë i varfërisë.

### **Grupet e marxhinalizuara**

Organizata të ndryshme japin klasifikime të ndryshme të grupeve të marxhinalizuara.

Sipas Bankës Botërore (Banka Botërore, 2013): *“Një grup vunerabël (i marxhinalizuar) është një popullsi që ka disa karakteristika specifike, të cilat bëjnë të ketë risk të lartë për të qenë të varfër”*. Grupet e marxhinalizuara përfshijnë: të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, të rinj dhe fëmijë në risk, ish-ushtarakë, refugjatë të kthyer, individë të infektuar me HIV/AIDS, minoritete fetare dhe etnike dhe në disa shoqëri edhe gratë.

Këshilli i të Drejtave të Njeriut në Kombet e Bashkuara (2014) përfshin në grupet e marxhinalizuara këto kategori: personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, gratë, komuniteti LGBT, minoritetet, indigjenët, refugjatët, persona të shpronësuar me forcë por që jetojnë brenda kufijve të vendit të tyre, azil-kërkuesit dhe punëtorët emigrantë.

Ndërkohë, UNDP (2011) përfshin kategori të tjera në grupet e marxhinalizuara si: të varfërit absolut, individët pa arsim ose me arsim fillor, të papunët, të vetëpunësuarit ose familjet e fermerëve që punojnë në bujqësi, personat pa tokë ose thuajse pa tokë në zonat rurale, gratë në nevojë, komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara.

Në projekt-ligjin për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë, grupet e pafavorizuara përcaktohen si grupet me probleme të varfërisë ekstreme, përjashtimit social për shkak të diskriminimit, papunësisë afatgjatë, vështirësive për shkak të të qenit i procedur penalisht apo nën varësinë e drogës dhe alkoolit, dhe personat e shpërngulur.

## Grupet e marxhinalizuara dhe pozicioni i tyre në tregun e punës

Në vitin 2008, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr.48, datë 16.01.2008, i cili vendosi masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta (Këshilli i Ministrave, 2008). Sipas këtij vendimi, “punëkërkuës të papunë nga grupet e veçanta” konsiderohen: a) të papunët afatgjatë; b) personat që përfitojnë ndihmë ekonomike; c) personat që përfitojnë pagesë papunësie; ç) personat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës, të moshës 18-25 vjeç; d) personat mbi 45 vjeç që nuk kanë një arsimim më të lartë se arsimit të mesëm ose ekuivalent të tij; dh) personat me aftësi të kufizuar; e) personat nga komuniteti rom dhe egjiptian; ë) emigrantët e kthyer me probleme ekonomike. f) viktima të trafikimit.

Edhe pse janë bërë përmirësime në ekonomi dhe niveli i varfërisë është ulur në mënyrë të konsiderueshme, çështja e marxhinalizimit të disa grupeve vazhdon të mbetet emergjente (UNDP, 2011). Marxhinalizimi i lidhur si me indikatorët ekonomikë dhe socialë dhe me aksesueshmërinë e shërbimeve i pengon grupet e marxhinalizuara për të ecur në të njëjtin drejtim me grupet e tjera në shoqëri. Pozicioni i grupeve të marxhinalizuara në tregun e punës ka një rëndësi të veçantë.

**Gratë** që jetojnë në familje që janë në varfëri absolute përbëjnë një grup specifik të marxhinalizuar. Përveç kufizimeve që kanë në të ardhura dhe konsum, ato përballen dhe me vështirësi të tjera në tregun e punës për shkak të përgjegjësive të mëmësisë dhe përkujdesjes ndaj fëmijëve apo përgjegjësive të tjera në familje që i mbartin kryesisht femrat (UNDP, 2011). Përveç arsyeve të mësipërme, niveli i ulët i arsimit të përgjithshëm në familje (ku martesat e hershme mund të shpjegojnë nivelet e ulëta të arsimit të grave në nevojë) është i lidhur direkt me pozicionin e dobët që kanë në tregun e punës. Ashtu si të varfërit në përgjithësi, gratë në nevojë janë të përqëndruara kryesisht në zonat rurale (60%) dhe në zonat malore (19.75%). Mesatarisht, 30% e grave në nevojë punojnë në ferma të zotëruara nga anëtarë të familjes. Gratë në nevojë punojnë kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe rritjes së peshkut, fabrika dhe pozicione të tjera elementare.

**Komuniteti Rom dhe Egjiptian** është ndër më të varfërit e popullsisë, të cilët vazhdojnë të jetojnë në banesa me mungesë kushtesh bazike, janë të paarsimuar dhe kanë normat më të larta të analfabetizimit në popullsi. Censusi i 2011 tregoi që në Shqipëri jetojnë 11669 romë dhe egjiptianë (8301 romë dhe 3668 egjiptianë). Mesatarisht, meshkujt romë kanë 3.8 vite arsim, ndërsa femrat romë kanë 3.1 vite (UNDP, 2011).



Pjesa më e madhe e komunitetit rom jeton në kushte shumë të vështira dhe shpesh me mungesa kushtesh bazike. Si rezultat i të jetuarit në vështirësi dhe kushteve ekonomike, fëmijët romë shpesh janë pjesë e tregut informal të punës me qëllim sigurimin e të ardhurave për familjen. Ka një mungesë mundësish punësimi për këtë komunitet, kështu që burimet kryesore të të ardhurave vijnë nga punë që kërkojnë pak aftësi dhe nga sektori informal. Aktivitetet kryesore në të cilat anëtarët e këtij komuniteti angazhohen janë mbledhja e skrapit, pastrimi i rrugëve, punët sezonale në sektorin bujqësor dhe shitja e rrobave të përdorura.

**Personat me aftësi të kufizuara** 6.2% e popullsisë së rritur ka deklaruar të paktën një aftësi të kufizuar (Ferré, Galanxhi, & Dhono, 2015). Grupmosha e të rriturve në moshë pune me aftësi të kufizuar është 2 herë më e prirur për të qenë e përjashtuar nga forca e punës sesa po e njëjta grupmoshë e aftë. Dominimi i aftësisë së kufizuar është i lidhur me moshën. Grupi i personave të moshës së tretë është më i prirur për të pasur aftësi të kufizuar. Diferenca midis meshkujve dhe femrave thellohet me moshën, veçanërisht për “vështirësinë në lëvizje”. Aftësia e kufizuar është e lidhur ngushtësisht me sëmundjet profesionale ose kronike, të cilat mund të ndikojnë në paaftësi me kalimin e moshës. Pjesa më e madhe e individëve me aftësi të kufizuar jetojnë në familje të mëdha. Më shumë se dy të tretat e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shikim, komunikim, kujtesë dhe kujdes vetjak janë të regjistruar në shkollë. Nga ana tjetër, vetëm gjysma e fëmijëve me vështirësi në lëvizje ose dëgjim janë të regjistruar në shkollë. Si përfundim, personat me aftësi të kufizuar kanë një nivel të ulët arsimi.

**Të rinjtë** (15-29 vjeç) përbëjnë 22.55% të popullsisë (45.95% femra dhe 54.05% meshkuj) (INSTAT, 2016). Prezenca më e madhe e meshkujve është midis grupmoshës 20-24 vjeç (55.6% kundrejt 44.4% femra). Të rinjtë në zonat urbane përbëjnë 62.77% dhe të rinjtë në zonat rurale përbëjnë 37.23% (INSTAT, 2015). Struktura e moshës së popullsisë ka ndryshuar për shkak të emigrimit, dhe kryesisht të të rinjve. Nga këndvështrimi politik kjo është një situatë shqetësuese, sepse reflekton punësimin e dobët dhe kushtet jo të mira të jetesës së kësaj pjese të popullsisë që është ekonomikisht më produktive dhe e aftë të mbështesë pjesën pasive të forcës së punës si mosha e tretë. Niveli arsimor i të rinjve shqiptarë është duke u rritur me ritëm të shpejtë. Ka një rritje të regjistrimit të të rinjve në universitete, nga 122 mijë në vitin akademik 2009-2010 në 174 mijë në 2013-2014. Në vitet e fundit, numri i studenteve femra në universitete është rritur më shumë se numri i meshkujve, i cili për vitin 2013-2014 arriti në 57% (INSTAT, 2015). Censusi i vitit 2011 regjistroi 8600 të rinj të grupmoshës 15-29 vjeç që nuk mund të lexojnë dhe shkruajnë. Përqindja e të rinjve të papunë ishte 32.5% në vitin 2014.

## Masa aktive për integrimin në punë të grupeve të marxhinalizuara

Ka disa masa ose iniciativa të ndërmarra për integrimin e disa prej grupeve të marxhinalizuara në tregun e punës si më poshtë:

### **Shërbimi Kombëtar i Punësimit**

Disa programe të nxitjes së punësimit janë zbatuar në Shqipëri që në 1999, me qëllim reduktimin e papunësinë dhe punës informale, për të shkuar drejt një punësimi të qëndrueshëm dhe jo fragmentar apo sezonal. Në kohën e censurit 2011, katër programe të nxitjes së punësimit dhe tre programe shtesë u zbatuan nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (INSTAT, 2015):

1. Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë në vështirësi, duke përfshirë të papunët afatgjatë që marrin ndihmë ekonomike, individët që marrin përfitime papunësie, personat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës të grupmoshës 18-25 vjeç, personat mbi 45 vjeç me arsim të mesëm ose më pak, personat me aftësi të kufizuara, romët dhe emigrantët e kthyer në vend që përballen me probleme ekonomike;
2. Programi i nxitjes së punësimit përmes trajnimit në punë;
3. Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë të diplomuar nga universitetet ndërkombëtare dhe shqiptare;
4. Programi i nxitjes së punësimit përmes trajnimit formal;
5. Programi i nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave që kërkojnë punë nga grupet e marxhinalizuara;
6. Programi i nxitjes së punësimit të të rinjve të papunë të grupmoshës 16-25 vjeç që hyjnë në tregun e punës për herë të parë;
7. Programi i nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

### **Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (2015-2020)**

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, si një strategji e zhvilluar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë erdhi si një nevojë në kushtet aktuale, jo vetëm sepse strategjisë së mëparshme të rinisë i përfundoi afati, por për shkak të nevojës për të qenë në përputhje me objektivat e qeverisë së re dhe ndryshimet kulturore, ekonomike dhe sociale në vend në vitet e fundit.

Qëllimi i këtij plani është zhvillimi dhe koordinimi i politikave ndërsektoriale të rinisë në arsim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe rritja e pjesmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe proceset e vendimmarrjes (Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, 2015).

Midis të gjitha objektivave kryesore të kësaj strategjie, e rëndësishme është nxitja e punësimit të të rinjve përmes *politikave efektive të tregut të punës*. Kjo është një iniciativë që promovon integrimin në punë të të rinjve.





### **Programi VET**

Projekti “Adresimi i përfshirjes sociale përmes formimit dhe arsimit profesional” (VET) është realizuar për të lehtësuar aksesin ndaj formimit dhe arsimit profesional duke nxitur pjesëmarrjen në VET, si dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale për të mbështetur përfshirjen e grupeve të marxhinalizuara në sistemin VET. Ka qenë një projekt i përbashkët i ILO/PNUD që zgjati dy vjet (2011-2013).

Një program tjetër që konsiston në formimin dhe arsimin profesional është zbatuar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), që përfaqëson Ministrinë gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Objektivi i përgjithshëm i programit VET është reduktimi i papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë. Të rinjtë dhe të rriturit e aftë për t’ju përgjigjur kërkesave në ndryshim të tregut të punës janë target të programit VET.

## **Roli i Modelit të Integritimit në punë në Shqipëri**

Të gjitha masat e ndërmarra nga qeveria në bashkëpunim me aktorët ndërkombëtarë për përfshirjen e grupeve të marxhinalizuara në tregun e punës kanë treguar se situata ende nuk ka ndryshuar. Grupet e marxhinalizuara mbeten një nga kategoritë, të cilët janë të përjashtuar nga jeta sociale dhe në nevojë kritike për punësim. Në 2008, Këshilli i Ministrave miratoi disa incentiva për punëdhënësit që do të punësonin persona nga grupet e marxhinalizuara. Incentivat konsistojnë në pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit potencial nga grupet e marxhinalizuara (Këshilli i Ministrave, 2008). Pavarësisht nga këto incentiva dhe njohja e kapacitetit të kufizuar të biznesit pas krizës, numri i punonjësve nuk është rritur dhe veçanërisht numri i punonjësve që i përkasin grupeve të marxhinalizuara. Në këtë kontekst, qeveria miratoi një projekt-ligj mbi ndërmarrjet sociale, i cili synon të promovojë modelin e integritimit në punë, si një mjet për të zgjidhur këtë çështje. Me anë të këtij modeli, grupet e marxhinalizuara mund të kalojnë nga përfitues pasiv të ndihmës ekonomike në pjesëmarrës aktiv në tregun e punës. Në terma të sakta, qëllimi kryesor i modelit të integritimit në punë nëpërmjet NSve është të ndihmojë individë të pakualifikuar e të papunë, të cilët janë të përjashtuar nga tregu i punës.

### **Projekt-ligji për Ndërmarrjet Sociale**

Që prej vitit 2010, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë filloi përgatitjen e ligjit mbi Ndërmarrjet Sociale. Në 2015, një grup pune ndërsektorial i përbërë nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes punuan për projektligjin e ri. Sipas projekt-ligjit, ndërmarrje sociale është një status i dhënë nga ministri përgjegjës për çështjet sociale. Vetëm organizatat jofitimprurëse mund të aplikojnë për këtë status. OJFtë duhet të ofrojnë të mira dhe shërbime në fusha si: shërbimet sociale, punësimi i grupeve të marxhinalizuara, punësimi i të rinjve, kujdesi shëndetësor, mbrojtja mjedisore, promovimi i turizmit, kultura dhe trashëgimia kulturore, aktivitetet sportive dhe promovimi i zhvillimit të komuniteteve lokale. Sipas projekt-ligjit, të paktën 30% e punonjësve duhet ti përkasin grupeve të marxhinalizuara.



## Pyetjet Kërkimore

Në përputhje me qëllimin e studimit, janë ngritur tre pyetje, me qëllim eksplorimin dhe përshkrimin e çështjeve të lartpërmendura, për të kuptuar nëse modeli i integritit në punë mund të luajë një rol të rëndësishëm në Shqipëri. Pyetja e parë synon identifikimin e tipologjive të modeleve të ndërmarrjeve sociale në Shqipëri bazuar në disa karakteristika të tilla si lloji i misionit, struktura e pronësisë dhe qeverisja, dhe struktura financiare, duke përdorur instrumentin e ICSEM. Pyetja e dytë kërkimore synon jo vetëm të eksplorojë situatën e përditshme të grupeve të marxhinalizuara, por veçanërisht vullnetin dhe nevojën e tyre për punësim. Është gjithashtu e nevojshme të kuptojmë nëse këto individë të papunë, të cilët marrin ndihmë ekonomike janë të gatshëm të tërhiqen nga skema e përfitimit social dhe të gjejnë një punë. Pyetja e fundit synon të kuptojë dhe të theksojë mundësitë e ofruara nga ndërmarrjet sociale në tregun e punës, dhe gjithashtu sfidat me të cilat ata përballen, të cilat vështirësojnë punësimin e grupeve të marxhinalizuara. Në vijim paraqiten pyetjet kërkimore:

- Cilat janë modelet e ndërmarrjeve sociale që ekzistojnë në Shqipëri?
- Si e perceptojnë punësimin grupet e marxhinalizuara dhe procesin e trajnimit para hyrjes në tregun e punës?
- Çfarë roli dhe impakti mund të kenë NSTë për grupet e marxhinalizuara në tregun e punës?

## Struktura e studimit

Ky seksion është një udhërrëfyes i mënyrës se si është organizuar studimi.

**Kapitulli i parë** paraqet një rishikim të modeleve të ndërmarrjeve sociale kudo në botë, veçanërisht të modelit të integritit në punë dhe kuadrit ligjor në shtete të ndryshme bazuar në një vështrim literature.

Në vijim, **kapitulli i dytë** ofron një vështrim të kontekstit politik dhe ekonomik në Shqipëri, me qëllim njohjen e historisë së ndërmarrjeve sociale dhe modelet e NSve që dominojnë ditët e sotme. Githashtu, në këtë kapitull përshkruhen mekanizmat mbështetëse dhe incentivat financiare që lehtësojnë aktivitetin e ndërmarrjeve sociale.

**Kapitulli i tretë** shpjegon metodologjinë e ndjekur në këtë studim, instrumentat e përdorur, fazat e mbledhjes së të dhënave, karakteristikat e çdo kampioni të përzgjedhur dhe pyetjet kërkimore.

**Kapitulli i katërt** përshkruan gjetjet, të cilat ndahen në dy nënkapituj: gjetjet mbi ndërmarrjet sociale dhe gjetjet mbi grupet e marxhinalizuara.

**Në kapitullin e pestë** diskutohen dhe analizohen gjetjet duke iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të ngritura në studim dhe jepen kufizimet e studimit.

**Kapitulli i gjashtë** përshkruan rekomandimet e nxjerra nga ky studim, të cilat i adresohen kryesisht qeverisë dhe politikëbërësve.



# Kapitulli 1

## Vështrim literature

Ndërmarrja sociale vazhdon të jetë një koncept jo shumë i njohur, pa një përkufizim të pranuar gjerësisht dhe që mer kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Kjo vlen edhe për përkufizimin e entiteteve që veprojnë si ndërmarrje sociale, që referohen si një aktivitet, një organizate apo një institucion i veçantë (Borzaga & Galera, 2009).

Në Europë, koncepti i ndërmarrjeve sociale fillimisht u shfaq në fillim të viteve '90, në zemër të sektorit të tretë. Sipas traditës europiane (Evers & Laville, 2004), sektori i tretë bën bashkë kooperativa, shoqata, shoqëri të bashkëpunimit reciprok dhe fondacione - pra, me fjalë të tjera, të gjitha organizatat private jofitimprurëse; një sektor i tillë emërtohet si "ekonomia sociale" në shumë vende të Europës. Më saktësisht, iniciativa e parë lindi në Itali dhe ka qënë ngushtësisht e lidhur me lëvizjen e kooperativave. Në vitin 1991, Parlamenti italian miratoi një ligj për krijimin e një forme ligjore specifike për "kooperativat sociale", të cilat më vonë pësuan një rritje shumë të madhe.

## SHKOLLAT KRYESORE TË MENDIMIT MBI NDËRMARRJET SOCIALE

Ka tre shkolla kryesore mendimi që janë zhvilluar në këtë fushë. **Shkolla e parë e mendimit** mbi ndërmarrjet sociale i referohet kryerjes së aktiviteteve nga organizatat jofitimprurëse në mbështetje të misionit të tyre (Defourny & Nyssens, 2010). Brenda kësaj shkolle mendimi, është bërë një dallim midis versionit të mëparshëm, duke u fokusuar në sektorin jofitimprurës të quajtur 'qasja komerciale jofitimprurëse', nga njëra anë, dhe një versioni më të gjerë që i përfshin të gjitha format e biznesit, i quajtur "qasja e biznesit e orientuar nga misioni" nga ana tjetër (Defourny & Nyssens, 2012).

Gjithashtu, brenda kësaj qasje të gjerë mund të përmendet koncepti i biznesit social i promovuar nga Yunus (2010), megjithëse përfshin kushte të forta: "*Një biznes social është një kompani pa humbje, pa dividend e formuar për të adresuar një objektiv social*". Ky koncept u zhvillua kryesisht për të përshkruar një model biznesi që fokusohet në ofrimin e të mirave ose shërbimeve drejt klientëve

të varfër kryesisht në vendet në zhvillim. Një biznes i tillë social supozohet të mbulojë të gjitha kostot përmes tregut. Kjo është një formë tipike, e zotëruar nga investitorët, të cilët, të paktën në versionin e Yunus, nuk marrin pjesë nga fitimi i kompanisë dhe të gjitha fitimet ri-investohen totalisht për të mbështetur misionin social (Defourny & Nyssens, 2012).

Organizatat si Ashoka kanë nxitur një **shkollë të dytë të madhe mendimi**, e quajtur “Inovacioni Social”. Dees (1998) ka propozuar përkufizimin më të mirë të njohur të sipërmarrësit social në këtë shkollë mendimi. Ai i shikon sipërmarrësit social si “agjentë ndryshimi në sektorin social duke adoptuar një mision për të krijuar dhe mbajtur vlerën sociale, të angazhuar për të ndjekur mundësi të reja që i shërbejnë këtij misioni, duke u përfshirë në një proces inovacioni të vazhdueshëm, përshtatjeje dhe të mësuari, dhe më në fund shfaqjen e një sensi përgjegjshmërie ndaj grupeve të interesit që iu shërbehet dhe për rezultatet e krijuara”.

Borzaga & Galera (2009) shpjegon se dallimi midis ndërmarrjes sociale dhe tregtare nuk është në mënyrë strikte dikotomik, por mund të kuptohet si një kontinuum, që ka një diapazon nga ndërmarrje e pastër sociale në ndërmarrje e pastër me qëllim fitimi, secila me elementët e saj. Sidoqoftë, çdo ndërmarrje duhet të përmbushë dy kushte. Kushti i parë është **rëndësia sociale e veprimtarisë** dhe kushti i dytë është **qëndrueshmëria ekonomike**.

E treta është **përqasja e përdorur nga EMES<sup>2</sup>**, një ndër qasjet më të përdorura mbi ndërmarrjet sociale, sidomos në Evropë, e cila derivon nga një dialog i gjatë midis disiplinave të ndryshme (ekonomia, sociologjia, shkencat politike dhe manaxhimi) dhe po ashtu midis modeleve të ndryshme prezente në Bashkimin Europian. Defourny & Nyssens (2008) i përkufizojnë ndërmarrjet sociale si: *“organizata private jofitimprurëse që ofrojnë të mira ose shërbime, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me qëllimin e tyre parësor në të mirë të komunitetit. Ato mbështeten në një dinamikë kolektive që përfshin lloje të ndryshme grupesh interesi në organizmat qeverisës, ato vendosin një vlerë të lartë në autonominë e tyre dhe përballojnë riskun ekonomik lidhur me aktivitetin e tyre”*.

Indikatorët e prezantuar nga EMES nuk kanë pasur kurrë qëllim të përfaqësojnë një set kushtesh që një organizatë duhet t'i plotësojë me qëllim që të cilësohet ndërmarrje sociale. Më tepër se disa kriteret normative, ata përshkruajnë një “tip ideal” në termat e Weber, një prototip abstrakt që mundëson që studiuesit të pozicionojnë veten brenda “galaksisë” së ndërmarrjeve sociale (Defourny & Nyssens, 2012). Tre elementët kryesorë që duhet të plotësojë ky model janë si më poshtë:

2 EMES është një rrjet kërkimor/studimesh i qendrave kërkimore të universiteteve dhe studuesve individual, qëllimi i të cilëve deri tani ka qenë ndërtimi gradual i një korpusi ndërkombëtar njohurish teorike dhe empirike, pluralist në disiplina dhe metodologji, rreth konceptit të “NS”, ndërmarrje sociale, sipërmarrja sociale, ekonomia sociale, ekonomia e solidaritetit, inovacioni social, etj.



### **Një projekt ekonomik**

- Prodhim i vazhdueshëm,
- Punë e paguar,
- Një risk ekonomik.

### **Një mision social**

- Një qëllim social i shprehur,
- Shpërndarje e limituar e fitimit, që reflekton paritetin e qëllimit social,
- Një iniciativë e lançuar nga një grup qytetarësh ose organizata të sektorit të tretë.

### **Një qeverisje me pjesëmarrje**

- Një shkallë e lartë autonomie,
- Një natyrë pjesëmarrëse, e cila përfshin palë të ndryshme të ndikuara nga aktiviteti,
- Një fuqi vendimmarrëse jo e bazuar në pronësinë e kapitalit.

## **KUADRI LIGJOR I NDËRMARRJEVE SOCIALE NË SHTETE TË NDRYSHME**

Në 1991, parlamenti Italian miratoi një ligj duke krijuar një formë specifike ligjore të quajtur "kooperativat sociale". Ligji njohu dy lloje të ndryshme kooperativash sociale: ato që ofrojnë shërbime sociale, shëndetësore dhe edukimi, të quajtura "kooperativat sociale të tipit A", dhe ato që ofrojnë integrimin në punë të grupeve të pafavorizuara, referuar si "kooperativat sociale të tipit B". Pas më shumë se një dekade pas Italisë, qeveria britanike ndërmorri iniciativën e parë. Ata i përkufizuan ndërmarrjet sociale si "*biznese me objektiva kryesisht sociale, tepërcat e të cilave riinvestohen kryesisht për këtë qëllim në biznes ose në komunitet, më tepër sesa të udhëhiqen nga nevoja për të maksimizimuar fitimin për aksionerët dhe pronarët*" (DTI, 2002, p. 7).

Për më tepër, një formë e re ligjore, "Kompani me Interes Komunitetin" (KIK), u aprovua nga parlamenti britanik në 2004. Kjo formë e re ligjore siguron që ndërmarrjet sociale janë të dedikuara ndaj qëllimeve për komunitetin (Defourny & Nyssens, 2008). Ndërmarrjet sociale mund të marrin forma të ndryshme si: bizneset sociale, kooperativat, bizneset e zotëruara nga punonjësit, unionet e kreditit, bizneset komunitare, firmat sociale, kompanitë e ndërmjetme të tregut të punës, organizata të bazuara te komuniteti, të drejtuara nga qëllimi social, mjedisor dhe ekonomik brenda komunitetit të përcaktuar (SEL, 2001).

Në Francë, Spanjë dhe Greqi format ligjore janë të tipit të kooperativave. Forma ligjore portugeze "kooperativa e solidaritetit social" konsiston në ofrimin e shërbimeve me synim rritjen e integritit të grupeve vunerabël, si fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet/komunitetet e pafavorizuara.

Kooperativat sociale portugeze bëjnë bashkë disa grupe interesi si përdorues të shërbimeve, punonjës dhe vullnetarë. Ato janë të ndaluara të shpërndajnë fitim tek anëtarët. Për Spanjën, një ligj kombëtar krijoi emërtimin “kooperativa sociale të iniciuara”; - këtë emërtim mund ta përdorë çdo tip kooperative që ofron shërbime sociale ose zhvillon një aktivitet ekonomik me qëllim integrimin në punë të grupeve sociale të përjashtuara. Forma ligjore spanjolle lidhur me ndërmarrjet sociale është shumë e ngjashme me homologët portugezë, sepse edhe në këtë formë fitimi nuk mund të shpërndahet. Diferenca midis formave ligjore të dy shteteve është që forma organizative në Spanjë është zakonisht e orientuar nga një strukturë me shumë grupe interesi sesa në rastin e Portugalisë.

Nga ana tjetër, modeli socio-ekonomik gjerman është bazuar në një marrëveshje partneriteti rreth konceptit “ekonomi sociale tregu”, e perceptuar si një lidhje specifike midis tregut dhe shtetit për të forcuar zhvillimin socio-ekonomik. Në një model të tillë është e vështirë të dallohen rolet specifike të ndërmarrjeve sociale (Defourny & Nyssens, 2008).

Koncepti i ndërmarrjeve sociale në Shtetet e Bashkuara është më i gjerë dhe më i fokusuar në gjenerimin e të ardhurave dhe ndërmarrjet me aktivitet tregtar. Në qarqet akademike në SHBA, ndërmarrjet sociale janë kuptuar si një kontinuum që varion nga bizneset e orientuara nga fitimi të angazhuara në aktivitete të dobishme sociale (përgjegjësia sociale e korporatave) në biznese me qëllime dualiste që kanë si qëllimi fitimin dhe objektivat sociale (hibride) dhe deri në organizata jofitimprurëse të angazhuara në aktivitete tregtare të mbështetura te misioni (organizata me qëllim social) (Kerlin, 2006). Në SHBA, ndërmarrjet sociale marrin forma të ndryshme ligjore, duke përfshirë: person fizik, korporata, ortakëri, kompani me përgjegjësi të kufizuar, organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse (Borzaga & Galera, 2009).

## **INTEGRIMI NË PUNË SI NJË FUSHË E RËNDËSISHME AKTIVITETI PËR NDËRMARRJET SOCIALE**

Ndërmarrjet sociale mund të operojnë në një spektër të gjerë aktivitete, sepse “qëllimi social” mund ti referohet disa fushave të ndryshme. Megjithatë në Europë është dominant një tip i ndërmarrjeve sociale, i emërtuar “ndërmarrje sociale që sigurojnë integrimin në punë” (Nyssens, 2006). Në të vërtetë, ashpërsia e papunësisë strukturore midis disa grupeve, kufizimet e politikave tradicionale aktive të tregut të punës dhe nevoja për politika integrimi më aktive dhe inovatore ka ngritur pyetje lidhur me rolin që ndërmarrjet sociale duhet të luajnë në reduktimin e papunësisë dhe forcimin e rritjes ekonomike. Në terma konkret qëllimi kryesor i kësaj forme është të ndihmohen personat e pakualifikuar të papunë, që janë përjashtuar nga tregu i punës (Defourny & Nyssens, 2008). Pjesa më e madhe e këtyre iniciativave në shtete të ndryshme janë ndërmarrë nga një grup personash, qëllimi i të cilëve ka qenë interesi i përbashkët. Por, në disa shtete me një traditë bashkëpunimi të fortë, iniciativat e para janë ndërmarrë nga vetë punëtorët dhe persona të pafavorizuar.



Siç u përmend më parë, në Itali u krijua “tipi B” i kooperativave sociale, i cili synonte t’i përgjigjej nevojave të papërmbushura, veçanërisht në fushën e integritimit në punë. Megjithëse këto iniciativa i shërbenin një komuniteti më të gjerë dhe theksonin dimensionin e interesit të përbashkët, realiteti tregoi që “tipi A” i kooperativave sociale ishte dominues në treg dhe vendet e punës të krijuara nga ato ishin shumë më të mëdha sesa “tipi B” i kooperativave sociale (integrimi në punë).

Në një numër shtetesh europiane, zhvillimi i skemave specifike publike targetoi këtë model ndërmarrjesh sociale. Akti Finlandez mbi ndërmarrjet sociale<sup>3</sup> është simbol i një prirje të tillë, sepse ruan termin “integrimi në punë”. Sipas këtij akti, një ndërmarrje sociale, pavarësisht statusit të saj ligjor është një ndërmarrje e orientuar nga tregu, e krijuar për punësimin e personave me aftësi të kufizuar ose për të papunët afatgjatë. Gjithashtu, Polonia e kaloi aktin mbi ndërmarrjet sociale, specifikisht të dedikuar për integrimin në punë të grupeve veçanërisht në nevojë (si ish të dënuarit, të papunët afatgjatë, personat me aftësi të kufizuara dhe të varurit nga droga ose alkooli). Duhet të theksohet që këto ligje të ndryshme nuk përcaktojnë ndonjë formë të re ligjore; ato më tepër krijojnë një mjet si një regjistër zyrtar për ndërmarrjet sociale.

Në Suedi, termi “kooperativa sociale” është bërë sinonim me “ndërmarrjet sociale që sigurojnë integrimin në punë”, edhe pse konteksti suedez karakterizohet nga zhvillimi i dinamikave të ndërmarrjeve sociale në fushën e shërbimeve personale, për shembull nën formën e kooperativave të punonjësve ose prindërve dhe shoqatave vullnetare (zakonisht me shumë grupe interesi). Në Francë, shërbimet e kujdesit të fëmijëve janë qartësisht një fushë kryesore e aktiviteteve për ndërmarrjet sociale, të cilat janë shpesh të vendosura dhe të manaxhuara nga prindërit dhe profesionistët si një përgjigje ndaj mungesës së shërbimit publik (Fraise, Lhuillier, & Petrella, 2007). Një tendencë e ngjashme mund të vëzhgohet në Greqi, ku kooperativat e agro-turizmit janë ngritur në zona të largëta, kryesisht nga gratë. Sidoqoftë, kur vëzhgohen format e reja ligjore, duket qartësisht që “kooperativat e bashkëpunimit reciprok” franceze dhe “kooperativat e solidaritetit social” portugeze nuk janë formuar veçanërisht si ndërmarrje për integrimin në punë, por fokusi kryesor është ofrimi i shërbimeve sociale. Edhe në shtete si Finlanda dhe Polonia, ku legjislacioni aktual mbi ndërmarrjet sociale është i lidhur vetëm me integrimin në punë, janë duke lindur fusha të reja aktiviteteve, si shërbimet sociale dhe komunitare (Defourny & Nyssens, 2008).

3 Akti Finlandez mbi ndërmarrjet sociale (1351/2003) u mirëkuptua në fund të vitit 2003, pas një përgatitjeje shumë të shpejtë të procedurave, dhe hyri në fuqi më 1 Janar 2004.

# Kapitulli 2

## Konteksti Shqiptar

Shqipëria me një popullsi prej 2,886,026 banorësh (INSTAT, 2016), është një vend me të ardhura mesatare dhe një nga ekonomitë në rritje në Europë.

### TRANZICIONI POLITIK

Shqipëria ka përjetuar transformime sociale, ekonomike dhe politike pas periudhës së regjimit komunist. Në vitin 1991, “Republika Socialiste” u shpërbë dhe u quajt “Republika e Shqipërisë”. Shpesh është trajtuar si “rasti më i vështirë” i ndryshimit të regjimit, ose si rast i veçantë krahasuar me vendet e tjera post-komuniste në Europën Lindore dhe Qëndrore. Rruga e gjatë dhe e vështirë, shpesh dhe kaotike drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut e ka vendosur vazhdimisht vendin në fund në renditjet rajonale post-komuniste që i janë bërë progresit ekonomik dhe demokratik (BTI, 2014).

Kushtetuta post-komuniste i garanton shtetit shqiptar monopolin në përdorimin e forcës, dhe ka detyrë të mbrojë “pavarësinë e shtetit dhe integritetin e territorit të tij”. Ndërsa në praktikë aftësia e shtetit për të kontrolluar territorin e tij u trondit pas krizës së vitit 1997, asistencë është ofruar nga vendet fqinje europiane. Kërcënimi nga emigrimi masiv, trafiqet e paligjshme dhe krimi i organizuar në kufijtë e shteteve të BE-së, ka inkurajuar aktivitetet për të mbikëqyrur dhe për të forcuar shtetin e brishtë. Asistenca nga jashtë ka ardhur veçanërisht në sektorët e sigurisë si policia dhe kontrolli i kufijve. Anëtarësia në NATO që në vitin 2009 ndihmoi ristrukturimin e një force ushtarake të vjetruar (BTI, 2014).

Bashkimi Europian po luan një rol të rëndësishëm gjatë viteve të fundit në aspektin ekonomik dhe politik në Shqipëri. Bashkë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria u njoh si një vend potencial për anëtarësimin në BE në vitin 2003. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit u firmos në 12 qershor 2006 dhe hyri në fuqi në 1 prill 2009. Marrëveshja për liberalizimin e vizave të Shqipërisë me vendet e BE-së hyri në fuqi në 2008. Në qershor të 2014, BE vendosi ti japë Shqipërisë *statusin kandidat* (European Union External Action, 2009). Integrimi në Bashkimin Europian do të ketë ndikimin e tij ekonomik, politik dhe social në shoqërinë shqiptare.





## **PERFORMANCA EKONOMIKE**

Shqipëria është konsideruar një ekonomi në rritje kryesisht për shkak të transformimeve strukturore të shkaktuara nga emigrimi dhe urbanizimi, të cilat mbështetën lëvizje në tregun e punës nga bujqësia në shërbime (sistemi bankar, telekomunikacion, turizëm), ndërtim dhe një përqindje më të vogël në prodhim. Bujqësia mbetet një nga sektorët më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm në Shqipëri, ku dominojnë fermat e vogla private, të cilat përbëjnë 21% të GDP-së dhe zënë rreth gjysmën e punësimit total. Sipas modelit ekonomik, Shqipëria ka ndjekur një model ekstremisht të hapur zhvillimi ekonomik që ka rezultuar në barriera të kufizuara në lëvizjen e faktorëve (BTI, 2014). Shteti ka përfituar nga një marrëveshje tregtie e lirë me Bashkimin Europian në vitin 2009, e cila ka lejuar eksportimin e mallrave shqiptarë lirisht në vendet e Bashkimit Europian.

Deri në 2008, para krizës financiare globale, Shqipëria kishte norma rritjeje të shpejta deri në 6% dhe reduktim të shpejtë të varfërisë nga 25% në 2002 në 12% në 2008 (Banka Botërore, 2008). Sidoqoftë pas vitit 2008, shteti filloi të përjetojë efektet e para të krizës globale, duke treguar rënie në rritjen ekonomike nga 7.5% në 2008 në rreth +2.02% në 2014 (INSTAT, 2014). Borxhi publik vazhdoi të rritet që nga viti 2008 nga 54.7% në 72.1% të GDP-së nga fundi i vitit 2014 (Banka Botërore, 2015).

Forca e punës tregoi një rënie gjatë viteve, me një normë papunësie që u rrit nga 13% në 2008 (INSTAT, 2008), në 17.9% në 2014, me një rënie të pjesëmarrjes së të rinjve në forcën e punës (INSTAT, 2015). Pjesëmarrja e të rinjve (15 - 29) në forcën e punës u ul nga 54.8% në 2011 në 41.9% në 2014 (INSTAT, 2011; INSTAT, 2015). Nga pikëpamja gjinore, ka një rënie të pjesëmarrjes së femrave të reja në forcën e punës, që rezulton në 32% kundrejt meshkujve të rinj prej 51.2% në fund të vitit 2014. E njëjta diferencë alarmante e performancës në forcën e punës është parë dhe midis femrave (51.3%) dhe meshkujve (72.2%) të grupmoshës 15-64 vjeç (INSTAT, 2015).

Shqipëria ka bërë përmirësime në klimën e investimeve të biznesit në vitet e fundit duke përmirësuar renditjen e saj në Indeksin e Konkurrencës Globale (nga vendi i 108 në 2008-2009 në vendin e 97 në 2014-2015) (World Economic Forum, 2015). Në 2007, Shqipëria krijoi një kuadër strategjik për zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SMEtë), miratoi strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe të Investimeve (2007-2013) si dhe një program afatmesëm për zhvillimin e SMEve. Disa reforma u paraqitën duke përfshirë thjeshtëzimin e procedurave për krijimin e një biznesi dhe regjistrimin e pronës; një ligj të ri prokurimesh duke përfshirë prokurimin online, ligj për falimentin dhe kompanitë; modernizimi i sistemit doganor dhe krijimi i një regjistri publik kreditimi (Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, 2014).

Pavarësisht reformës, niveli i sipërmarrjes së femrave dhe start-upeve të reja është shumë i ulët, i penguar nga regjistrimi i pronës dhe aksesimi në marrjen e kredive. Faktorët më problematik në bërjen e biznesit mbeten korrupsioni, pavarësisht reduktimit të tij në 2012-2013 krahasuar me vitet e mëparshme; legjislacioni tatimor dhe aksesimi në financa.



## NJOHJA E KONTEKSTIT DHE KONCEPTIT TË NSve

Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale, si një formë e re e ekonomisë, është ende në fazat e para të zhvillimit në Shqipëri. Së fundmi është miratuar Ligji për Ndërmarrjet Sociale, por mbetet ende për t'u përgatitur gjithë kuadri ligjor dhe rregullator që do të mundësojë dhe rregullojë veprimtarinë e tyre në të ardhmen.

Edhe pse nuk ka një përkufizim të pranuar gjerësisht, ndërmarrjet sociale operojnë nën një përkufizim të përdorur më shpesh: “ndërmarrjet sociale kombinojnë qëllimin social me shpirtin sipërmarrës”. Këto janë kompani që sigurojnë fitim, por fitimi riinvestohet në sigurimin e produkteve dhe shërbimeve për të arritur një ndikim më të gjerë social në komunitetet ku ato veprojnë dhe shërbejnë (Komisioni Europian, 2014). Pavarësisht përkufizimit të termit, ekzistencës ose jo të një kuadri ligjor që përcakton aktivitetet, NSTë janë një realitet ekonomik premtues në Shqipëri. Aktivitetet e tyre janë diverse dhe eficiente që nga kontributi në përfshirjen sociale të grupeve të marxhinalizuara, deri te punësimi dhe rritja ekonomike në Shqipëri, por duhet përmendur se ndërmarrjet sociale janë akoma në fazat fillestare të zhvillimit.

## PRESPETIVA HISTORIKE E NSve

Në rastin shqiptar, duhet theksuar që është e vështirë të hiqen vija paralele midis kooperativave dhe kuadrit ligjor respektiv, para dhe pas viteve '90'. Kjo për vetë faktin që kooperativat e krijuara nën regjimin komunist ishin detyrimisht në pronësi të shtetit që manaxhonte këto forma bashkëpunimi, dhe nuk aplikoheshin asnjë parim pronësie anëtarësh, etj.

Efektet e shpronësimit të popullsisë rurale dhe urbane gjatë procesit të ndërtimit të kooperativave dhe procesi i detyruar i krijimit të këtyre formave të prodhimit bujqësor, por jo të tregtisë, vazhdon ta deformatë dhe pengojë procesin e pastër të krijimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, blegtorisë apo çdo lloj tjetër shoqërie bashkëpunimi. Një dëm tjetër i derivuar nga kjo praktikë që akoma vazhdon në mentalitetin shqiptar është orientimi i kooperativave totalisht në zonat rurale dhe prodhimin bujqësor. Ky fakt ka “vlarë” dhe shpirtin sipërmarrës të disa gjeneratave si në zonat rurale dhe ato urbane.

Kooperativat para viteve '90 nuk kishin ndonjë element demokratik në themel të tyre. Nga këndvështrimi social, ato nuk bazoheshin dhe orientoheshin drejt principeve të lirisë së zgjedhjes. Nga këndvështrimi ekonomik, anëtarët e këtyre kooperativave nuk zotëronin gjë në terma kapitali, mjeteve prodhimi dhe makinerish, dhe as vetë produktet. Gjithçka ata zotëronin ishte forca e punës, dhe ajo ishte shumë pak e paguar dhe duke analizuar përfitimet sociale të kooperativave para viteve '90 këto s'ishin aq të rëndësishme krahasuar me dëmin ndaj parimeve të të drejtave të njeriut, të drejtave ekonomike dhe shpirtit sipërmarrës të gjeneratave rurale dhe urbane të shqiptarëve.

Kështu, është e dukshme që nocioni i kooperativave i parë nën këto dy sisteme politike është aq i ndryshëm sa dhe vetë sistemet.



Megjithatë, në 10-15 vitet e fundit, ka pasur përpjekje dhe janë vënë re zhvillime në këtë aspekt. Ka disa tipe të ndryshme modelesh të ndërmarrjeve sociale që kanë lindur dhe janë duke dhënë rezultate dhe shembuj të mirë në këtë drejtim.

## **Kuadri ligjor dhe institucional i NSve**

Koncepti i ndërmarrjeve sociale është akoma i paqartë dhe i debatueshëm në Shqipëri, pavarësisht disa përpjekjeve të bëra vitet e fundit për të paraqitur dhe përkufizuar konceptin dhe për të mbështetur zhvillimet e tij edhe pse në një mënyrë të fragmentuar.

Në vitin 2011, qeveria themeloi “Agjencinë për Nxitjen e Biznesit Social” me qëllimin për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social përmes nxitjes së qëndrueshme, të balancuar dhe koheziv të biznesit social në nivel kombëtar (Fletorja Zyrtare, 2011). Agjencia është një shoqëri aksionere në zotërim të shtetit. Kapitali fillestar i Agjencisë u siguroi nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat vijnë nga fonde të marra nga buxheti i shtetit, nga donatorë, bashkëpërfitues, njësi të qeverisjes vendore dhe burime të tjera.

Që prej vitit 2010, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë filloi përgatitjen e ligjit mbi Ndërmarrjet Sociale. Në 2015, një grup pune ndërsektorial i përbërë nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes punuan në projektligjin e ri. Sipas projektligjit, ndërmarrje sociale është një status i dhënë nga ministri përgjegjës për çështjet sociale. Vetëm organizatat jofitimprurëse mund të aplikojnë për këtë status. OJFtë duhet të ofrojnë të mira dhe shërbime në fusha si: shërbimet sociale, punësimi i grupeve të marxhinalizuara, punësimi i të rinjve, kujdesi shëndetësor, mbrojtja mjedisore, promovimi i turizmit, kultura dhe trashëgimia kulturore, aktivitetet sportive dhe promovimi i zhvillimit të komuniteteve lokale.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, gjithashtu parashikon në objektivat e saj një fokus të veçantë mbi përfshirjen sociale, kohezionin social dhe territorial, me një fokus të veçantë në zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve sociale dhe vëmendje ndaj barazisë gjinore dhe aksesit të grave dhe vajzave në tregun e punës. Gjithsesi, një plan i detajuar veprimi nevojitet që të bëhet publik.

Dialogu dhe partneriteti me aktorë biznesi për të rritur zhvillimin e vendit dhe zgjeruar format e të bërit biznes zë një fokus të veçantë dhe manifestohet përmes Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve në Republikën e Shqipërisë, 2014-2020 dhe planit të saj të veprimit (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, 2014). Kjo strategji orienton ekonominë shqiptare drejt një modeli gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe të zgjedhur, çka synon përmirësimin e situatës në tregun e punës dhe standarteve të jetesës për qytetarët shqiptarë.

## Modelet e ndërmarrjeve sociale

Ndërmarrjet e para sociale në Shqipëri kanë filluar aktivitetin e tyre para vitit 2000, si pjesë e aktivitetit të projekteve dhe programeve jofitimprurëse të mbështetura nga donatorët e huaj. Ndërmarrjet sociale që veprojnë sot janë kryesisht *organizata jofitimprurëse* dhe vetëm pak kanë status fitimprurës. Sektori jofitimprurës është gjenerues i formave të para të ndërmarrjeve sociale në vend (Partnerët Shqipëri, 2013). Kuadri ligjor që rregullon sektorin dhe varietetin e financimit dhe donatorëve kanë krijuar terrenin për këto forma të NSve.

Studimet më të fundit tregojnë që pjesa më e madhe e organizatave jofitimprurëse ofrojnë më shumë sesa një lloj shërbimi dhe targetojnë grupe/kategori të ndryshme. Misioni i tyre mund të jenë shërbimet dhe/ose të mirat sociale si dhe integrimi në punë (TACSO Project & ASE Forum, 2013). Përqëndrimi më i lartë i NSve është vërejtur në Tiranë dhe qytetet e mëdha.

Sektori jofitimprurës në Shqipëri konsiston në tre forma ligjore: *shoqata* (organizata me anëtarësi, kryesisht i shërbejnë anëtarëve të tyre), *qendra dhe fondacione* (organizata pa anëtarësi që i shërbejnë interesit publik) të përcaktuara në ligjin për Organizatat jofitimprurëse (Fletorja Zyrtare, 2001) dhe dy amendimente shtesë (Fletorja Zyrtare, 2007; Fletorja Zyrtare, 2013) dhe ligji për Regjistrimin e OJFve (Fletorja Zyrtare, 2001). Regjistrimi i OJFve është centralizuar në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë. Kuadri ligjor lejon një proces relativisht të drejtpërdrejtë regjistrimi dhe veprimi, në përputhje me standartet ndërkombëtare. Fondacionet janë entiteti i vetëm që kërkohet të ketë kapital para regjistrimit, madhësia e të cilit nuk përcaktohet në ligj. Një organizatë jofitimprurëse mund të kryejë aktivitet ekonomik pa nevojën për të krijuar një subjekt më vete për këtë arsye, me kusht që aktiviteti të jetë në përputhje me qëllimet e organizatës, deklarohet si një burim të ardhurash dhe nuk përbën burimin kryesor të të ardhurave. Fitimet nga aktiviteti ekonomik duhet të përdoren për të përmbushur qëllimet e specifikuar në aktin e themelimit.

Një model tjetër i spikatur i NSve janë *kooperativat*, si forma ligjore të rregulluara përmes Ligjit Nr. 38/2012 "*Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor*", (Fletorja Zyrtare, 2012). Ligji bazohet në një kuadër ligjor më të gjerë, në Ligjin Nr. 8088/1996 për "*Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok*", (Fletorja Zyrtare, 1996), në Ligjin Nr.9039/2003 *Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8088/1996 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok"* (Fletorja Zyrtare, 2003) dhe Ligjin Nr. 9747/2007 *Për disa ndryshime në ligjin nr.8088, datë 21.3.1996 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok", të ndryshuar* (Fletorja Zyrtare, 2007). Objekti i aktiviteteve të shoqërive të bashkëpunimit reciprok është realizimi i aktiviteteve ekonomike bashkarisht nga të gjithë anëtarët. Ata mund të bashkohen dhe të krijojnë federata për të mbrojtur dhe promovuar interesat e tyre të gjera. Sipas ligjit, aktivitetet ekonomike mund të jenë të ndryshme, si në fushën e prodhimit, shitjen e produkteve, fushën e shërbimeve, etj. Anëtarët e organizatave mund të jenë persona fizikë dhe juridikë, të cilët dëshirojnë të realizojnë bashkërisht aktivitete ekonomike brenda shoqërisë.



Ata kanë të drejta dhe detyra të barabarta, marrin vendime bashkë dhe çdo anëtar ka një votë. Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok janë formacione të ngjashme me shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, por të konsideruara si më të përshtatshme si formë ligjore për sektorin e kreditimit, sigurimeve dhe ndërtimit.

Të dyja entitetet duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me qëllim marrjen e statusit ligjor. Bazuar në ligjin “Mbi Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”, kooperativa të reja janë regjistruar për prodhimin e vajit, drithërave dhe perimeve. Mungojnë të dhënat publike, por sipas Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka 37 shoqëri bashkëpunimi bujqësor, të cilat janë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Bazuar në këto të dhëna, shoqëria më e vogël e bashkëpunimit bujqësor ka 7 anëtarë, ndërkohë më e madhja ka 61 anëtarë. Krijimi i një sistemi informacioni bujqësor elektronik (regjistri i fermerëve, regjistri i kafshëve etj.) është konsideruar nga BE si thelbësor për krijimin e një bazë për manaxhimin e mirë financiar të asistencës kombëtare dhe të BEsë (Komisioni Europian, 2014).

Një tipologji tjetër NSsh në Shqipëri janë *Shoqëritë e kursim kreditit*, të cilat lindën në treg me miratimin e Ligjit Nr. 8782/2001 “Për Shoqëritë e Kursim Kreditit” (Fletorja Zyrtare, 2001) dhe krijuan Unionin Shqiptar të Shoqërive të Kursim Kreditit bazuar në të njëjtin ligj. Unioni shqiptar i shoqatave të kursim kreditit është një federate vullnetare e SHKKve, e krijuar dhe manaxhuar nga anëtarët e saj dhe administruar nga Bordi i Drejtorëve i zgjedhur nga anëtarët e tij. Misioni i këtij unioni është ofrimi i shërbimeve financiare tek anëtarët e SHKKve, banorët ruralë, me qëllimi nxitjen e aktiviteteve prodhuese, duke përmirësuar standartet e jetesës dhe vazhdimisht zonat rurale në zhvillim. Në 2013, unioni kishte 97 SHKK anëtarë, me një portofol total kreditimi prej 40 milionë Euro. Ndikimi i këtij unioni konsiston në mbështetjen që i jep zhvillimit progresiv të fermave shqiptare. Kjo arrihet nëpërmjet investimeve financuese dhe krijimit të strukturave në fshatra, të cilat kanë kapacitetin për të manaxhuar sistemin e kreditimit dhe projekte të thera zhvillimi. Kjo ka çuar në zhvillim ekonomik me një ndikim të konsiderueshëm në përmirësimin e standarteve të jetesës, rritjen e mundësive të punësimit dhe reduktimin e emigrimit. Unioni është klasifikuar si një nga 15 institucionet më të mira të mikro financimit në botë nga MIX Market (Banka Botërore, 2013).

## **Incentivat financiarë dhe mekanizmat mbështetës**

Ndërmarrjet sociale në Shqipëri operojnë në këto fusha kryesore aktiviteteve: punësimi i grupeve të pafavorizuara, arsimit (formal dhe profesional për njerëz jashtë sistemit të arsimit shtetëror dhe privat), zhvillimi ekonomik, social dhe kujdesi shëndetësor (Partnerët Shqipëri, 2013).

Në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë në sektorin bankar dhe të telekomunikacionit, bashkë me donatorët ndërkombëtarë është zhvilluar

mbështetja për të krijuar dhe zhvilluar ndërmarrjet sociale nëpërmjet financimit të NSve, huave të buta dhe donacioneve ndaj ndërmarrjeve po ashtu dhe mbështetjes përmes lehtësimit të punësimit dhe trajnimit për grupet e targetuara që kryesisht përfshijnë njerëz në situata të pafavorizuara ekonomike dhe sociale.

Disa programe të BEsë, të aplikuara në Shqipëri, që targetojnë zhvillimin social dhe ekonomik, janë një formë potenciale financimi për NSTë si: IPA SCF që mbështesin nxitjen e përfshirjes sociale dhe ekonomike të minoritetin rom dhe egjiptian; Programet IPA CBC që mbështesin zhvillimin ekonomik, kohezionin social; Programi People 2 People (P2P) që mbështet vizitat në institucionet dhe organizmat e BEsë për të shkëmbyer eksperiencë, dije dhe praktika të mira midis OJFve në shtete përfituese, anëtare të BE (Babovic, et al., 2014, p. 38).

Përsa i përket mbështetjes për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, instrumenti për Asistencë para Aderimit në BE për Zhvillimin Rural (IPARD) përbën një mekanizëm të rëndësishëm mbështetës. Thirrja e parë e IPARD për propozime - si skema e realizuar nga dhjetori i vitit 2012 deri në shkurt të vitit 2013, u ndoq nga dy thirrjet e tjera në prill 2013 dhe mars 2014. Buxheti i përgjithshëm i Skemës së Grantit është 8,270,000 Euro nga të cilat 6,200,000 Euro janë nga BE dhe 2,070,000 Euro janë kontribut kombëtar (EU, 2014).

Në nivel pushteti qëndror, ofruesi më i madh kombëtar i informacionit, njohurive teknike dhe ekonomike që mbështet rritjen e prodhimit dhe të ardhurave për kategori të ndryshme fermerësh në vend është Shërbimi Këshillimor Bujqësor apo Shërbimi i Ekstensionit. Shërbimi këshillimor ka një rol kyç në ofrimin e asistencës për kryerjen e aplikimeve, hartimin e projekteve dhe asistimin e fermerëve që marrin grante gjatë procesit zbatues.

Inkubatorët e biznesit (IB) dhe laboratorët janë një element i rëndësishëm i infrastrukturës institucionale për zhvillimin e ekonomisë sociale. Në Shqipëri, përpjekjet e para filluan në 1998 me krijimin e dy IBve në Tiranë dhe Shkodër, të cilat rezultuan jo të suksesshme. Ato u krijuan nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (sot Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë) me asistencën e Bankës Botërore (Fondi i Punësimit dhe Trajnimit të Ndërmarrjeve). IBtë morën subvencione në 3 vitet e para të veprimtarisë së tyre dhe më pas ndryshuan në të vetëfinancuara, por dështuan në qëndrueshmërinë e tyre. Gjatë 18 viteve të fundit, IB e Tiranës hapi 19 biznese të cilat punësuan vetëm 52 njerëz, kurse IB e Shkodrës vepronte më shumë si hapësirë me qera (AIDA, 2011). Programi strategjik për Zhvillimin e Inovacionit dhe Teknologjisë së SMEve 2011-2016 prezantoi një Program të ri për Inkubatorët e Biznesit, i cili do të pilotojë një inkubator biznesi në Tiranë. Si rrjedhojë, dy IB shtesë pritet të krijohen. Programi do të financohet brenda komponentit të konkureshmërisë së mbështetjes së ardhshme të IPA III (Babovic, et al., 2014, pp. 40-41).

Rrjetëzimi në nivel lokal dhe rajonal, veçanërisht midis aktorëve të NSve, është ende në fazën e lindjes, akoma për t'u zhvilluar dhe konsoliduar. Megjithatë, ka disa përpjekje ekzistuese që përbëjnë një bazë të mirë për premisat e një bashkëpunimi rajonal të ardhshëm. Disa nga këto përpjekje janë (Babovic, et al., 2014, pp. 43-45):



- Rrjeti Euclid është një rrjet pan-Europian që punon me shtetet anëtare të BEsë, duke përfshirë dhe Ballkanin Perëndimor, i cili për herë të katërt është duke manaxhuar programin ERASMUS, i cili është i hapur edhe ndaj shteteve joanëtare në BE si: Mal i Zi, Serbia, Shqipëria, Turqia dhe Maqedonia.
- Inovacioni Social European është një qendër online që shërben si një vend takimi, ku inovatorët nga 27 shtete anëtare të BEsë dhe vende nga Ballkani Perëndimor janë mbledhur së bashku për të krijuar një fushë inovacioni social, energjike dhe të efektshme në Europë. Platforma shërben për të ngritur zërin dhe vënë në lëvizje Europën për të udhëhequr globalisht praktikën e inovacionit social.
- Laboratori i Inovacionit Social (LIS) është një organizatë hibride rajonale që punon në fushën e inovacionit social në Ballkanin Perëndimor.
- Forumi i Ndërmarrjeve Sociale, një rrjet ndërmarrjesh sociale që mbështet organizata me qëllim inkurajimin e zhvillimit të inovacionit në Ballkanin Perëndimor u lançua në mars të 2014 me deklaratën e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për Zhvillimin e Sipërmarrjes Sociale (Partnerët Shqipëri, 2014).

Incentivat financiare për NSTë janë pothuajse inekzistente. Ka pak dispozita ligjore dhe rregullore, por dhe ato janë të pa aplikueshme ose janë subjekt keq interpretimi.

- Ligji i amenduar mbi OJFtë parashikon përjashtimin nga taksa mbi të ardhurat për të ardhurat e gjeneruara nga donacionet, grantet, interesat bankare dhe kuotat e anëtarësisë.
- SHKKtë janë të përjashtuara nga taksat mbi të ardhurat dhe fitimi në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligjin mbi SHKKtë dhe Unionin e tyre (Fletorja Zyrtare, 2001).
- Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, fokusi i të cilave është bujqësia dhe blegtoria kanë të drejtë të përfitojnë incentiva fiskale dhe ndihma të tjera nga shteti sipas Ligjit Nr. 9039 si dhe janë të përjashtuara nga taksat për pesë vitet e para të veprimtarisë (Fletorja Zyrtare, 2003).

Në projektligjin final mbi ndërmarrjet sociale në Shqipëri nuk ka incentiva të parashikuara për ndërmarrjet sociale, dhe në terma të përgjithshëm përcaktohet që "format e tjera të mbështetjes dhe incentivat janë të rregulluara nga legjislacioni përkatës mbi mbështetjen nga shteti, mbi taksat dhe mbi OJFtë". Projektligji gjithashtu i referohet "masave mbështetëse, të cilat përfshijnë mbështetjen financiare dhe masa të tjera", por nuk është e qartë çfarë mbështetje, kush do ta ofrojë mbështetjen, termat etj.

# Kapitulli 3

## Metodologjia

Ky studim është bazuar në një metodologji mikse, duke kombinuar instrumenta dhe të dhëna sasiore dhe cilësore. Përpunimi i të dhënave sasiore u krye nëpërmjet programit SPSS 20. Sidoqoftë, theksi më i madh është vendosur në qasjen cilësore, sepse vetë qëllimi kryesor i studimit është më shumë eksplorues dhe përshkrues i modeleve të NSve në Shqipëri, situatës së grupeve të marxhinalizuara dhe cilat janë mundësitë dhe sfidat për punësimin e këtyre grupeve në ndërmarrjet sociale. Studimi është kryer në tre faza.

*Së pari*, është kryer një analizë e të gjithë dokumentave dhe të dhënave sekondare që ekzitojnë mbi ndërmarrjet sociale, kuadrin ligjor ku ato veprojnë dhe për grupet e marxhinalizuara. Është realizuar dhe një rishikim literature mbi sipërmarrjen sociale, modelet e ndërmarrjeve sociale dhe kryesisht modelin e integritimit në punë. Kjo fazë e studimit është kryer në periudhën prill - qershor 2015 dhe gjatë studimit informacioni është përditësuar me të dhënat më të fundit.

*Së dyti*, u kryen intervista ballë për ballë me 30 ndërmarrje sociale të identifikuara. Pyetësi i përdorur për intervista është pyetësi i çertifikuar i projektit ICSEM<sup>4</sup>. Intervistat u kryen në periudhën qershor - korrik 2015.

*Së treti*, u kryen intervista ballë për ballë me 74 persona, pjesë e grupeve të marxhinalizuara. Të gjithë personat e përfshirë në kampion janë të papunë. Instrumenti i përdorur është një pyetësor gjysëm i strukturuar i hartuar nga skuadra kërkimore e projektit. Intervistat u kryen në periudhën tetor - nëntor 2015.

Për qëllime të përpunimit dhe analizës së të dhënave u përdor një platform online LimeSurvey<sup>5</sup>.

Kërkim të dhënash sekondare

Përmes rishikimit të literaturës është mbledhur informacion dhe të dhëna mbi ndërmarrjet sociale dhe kuadrin ligjor kudo në botë. Më pas është mbledhur informacion mbi ndërmarrjet sociale që nga epoka e regjimit komunist - iniciativat

4 Për më shumë mbi projektin, vizitoni: <http://www.iap-socent.be/content>

5 Për më shumë mbi LimeSurvey, vizitoni: <https://www.limesurvey.org>





ligjore të ndërmarrja dhe incentivat financiare të aplikuara gjatë këtyre viteve në Shqipëri. Gjithashtu, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna sekondare nga raporte dhe dokumenta mbi grupet e marxhinalizuara dhe masat që janë marrë për mbështetjen dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Një nga vështirësitë të hasura gjatë kësaj faze të hulumtimit ishte mungesa e të dhënave zyrtare të publikuara në veçanti për grupet e marxhinalizuara, ndaj disa nga gjetjet cilësore lidhur me grupet e marxhinalizuara në këtë studim përbëjnë një informacion të vlefshëm për të gjitha grupet e interesit dhe publikun e gjerë.

## **INSTRUMENTAT E PËRDORUR**

Siç përmendet më sipër, në fazën e parë u kryen intervista ballë për ballë me përfaqësues të ndërmarrjeve sociale. Instrumenti i përdorur është pyetësi i çertifikuar i projektit ICSEM. Projekti ICSEM ka për qëllim ndërtimin e njohurive rreth modeleve të ndërmarrjeve sociale të reja dhe të konsoliduara në treg, duke ndjekur praktika/metoda të përbashkëta me qëllim zhvillimin e analizave krahasuese ndërkombëtare. Duke qënë se një nga pyetjet kërkimore është hartëzimi dhe identifikimi i modeleve të ndërmarrjeve sociale në Shqipëri, u përdor ky pyetësor dhe të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet sociale në Shqipëri janë tashmë pjesë e bazës së të dhënave të projektit ICSEM.

Pyetësi u fokusua në katër dimensione të mëdha: 1) *identiteti i përgjithshëm i ndërmarrjeve sociale*, 2) *natyra e misionit social*, 3) *qeverisja & struktura e pronësisë dhe 4) struktura financiare*. Me synim përmbushjen e qëllimit kryesor të studimit, këtij pyetësi i është shtuar dhe një seksion tjetër që lidhet me *punësimin e grupeve të marxhinalizuara nga NStë*. Pyetësi u përkthye nga anglishtja në shqip, me qëllim që të përshtatej me personat e intervistuar. Intervistat ballë për ballë zgjatën rreth 90 minuta dhe u kryen nga grupi kërkimor. Intervistat u realizuan në ambientet e ndërmarrjeve sociale dhe zyrat e Partnerëve Shqipëri dhe në kohën që i përshtatej të intervistuarve.

Disa nga vështirësitë e hasura gjatë këtyre intervistave lidheshin me çështje të tilla si: kuptimi i mënyrës sesi funksionon një shoqatë kursim krediti, duke qënë se disa nga ndërmarrjet sociale të marra në studim janë shoqata kursim krediti. Menjëherë pasi u has kjo vështirësi nga intervistuesit, skuadra kërkimore i thelloi intervistat me SHKKtë me qëllim qartësimin e paqartësive të hasura. Një limitim tjetër i intervistave ishte mungesa e të dhënave të plota financiare nga ana e ndërmarrjeve sociale si: të ardhurat totale dhe asetet totale. Kjo, si rezultat i mungesës së informacionit nga përfaqësuesit e këtyre ndërmarrjeve dhe mungesës së dëshirës për të dhënë këtë informacion.

Gjatë fazës së dytë të hulumtimit u kryen intervista ballë për ballë me persona që i përkisnin grupeve të marxhinalizuara. Instrumenti i përdorur ishte një pyetësor gjysëm i strukturuar, kryesisht i bazuar në pyetje të hapura me qëllim mbledhjen e informacionit mbi perceptimin dhe përvojën e këtyre grupeve në jetën e tyre të përditshme dhe sfidat që ata hasin për t'u punësuar. Pyetësi u nda në katër seksione kryesore: 1) *të dhëna demografike*, 2) *punësimi*, 3) *rrethanat*



e jetesës dhe 4) *përfitimet sociale*. Intervista zgjati rreth 1 orë. Pas përzgjedhjes së kampionit (persona që i përkasin grupeve të marxhinalizuara) u caktua koha dhe vendi i realizimit të intervistës. Pas pilotimit të pyetësorit, u vu re që pyetjet duhet të riformuloheshin në një mënyrë më të thjeshtë, me qëllim që të përshtateshin me formimin e personave të intervistuar.

## PËRZGJEDHJA E KAMPIONIT

Përzgjedhja e kampionit për NSTë dhe personat e papunë nga grupet e marxhinalizuara, u bë sipas metodës “snowball sampling”, si metoda më e përshtatshme në kushtet e mosnjohjes së popullatës për të dyja grupet e marra në studim.

Përsa i përket kampionit të ndërmarrjeve sociale, pas identifikimit të 35 ndërmarrjeve sociale<sup>6</sup>, që ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri, u arrit të përfshiheshin në studim vetëm 30 prej tyre, të cilat iu përgjigjën ftesës për të qenë pjesë e këtij studimi. Grupi kërkimor realizoi intervista me përfaqësuesit e këtyre ndërmarrjeve, të cilët ishin drejtorë ekzekutivë, administratorë dhe manaxherë projekti. Kampioni i ndërmarrjeve sociale të marra në studim është i shpërndarë gjeografikisht në 8 qytete: Tirana (37%), Shkodra (17%), Elbasani (17%), Berati (13%), Lushnja (7%), Lezha (3%), Pogradeci (3%), dhe Gjirokastra (3%).

Përsa i përket kampionit të personave të papunë që i përkasin grupeve të marxhinalizuara, u kryen 74 intervista. Kategoritë e grupeve të marxhinalizuara, pjesë e kampionit janë: gratë (22%); personat me aftësi të kufizuara (15%); të rinjtë (13.5%); romët dhe egjiptianët (13.5%); të pastrehët (12%); personat nën varësi (12%); personat e pakualifikuar (12%). Në terma gjinore, kampioni është i përbërë nga 53% femra dhe 47% meshkuj. 95% e tyre banojnë në zona urbane dhe pjesa tjetër në zona rurale.

## KUFIZIMET E STUDIMIT DHE NEVOJA PËR KËRKIME TË MËTEJSHME

Studimi i kryer ka disa kufizime të ndryshme, të cilat përmenden më poshtë. Studimi është mbështetur kryesisht në një qasje eksploruese dhe përshkuese; për rrjedhojë paraqet kufizime në shpjegimin e çështjeve të caktuara të cilat kanë nevojë për t’u studiuar më tej. Në studimet e ardhshme duhet të bëhet një hulumtim më i thelluar mbi të dhënat sasiore dhe hulumtimi mund të shihet nga një këndvështrim tjetër ku qasja sasiore të marrë një rëndësi më të madhe. Gjithashtu, në studimet e ardhshme mund të ilustron dhe disa raste studimore apo të zhvillohet një analizë përmbajtjeje si për ndërmarrjet sociale dhe për grupet e marxhinalizuara, me qëllim ofrimin e një pamjeje më holistike mbi këtë çështje.

6 Ndërmarrje sociale konsiderohen të gjitha ato subjekte që e konsiderojnë organizatën e tyre si një ndërmarrje sociale dhe kanë të gjitha karakteristikat që duhet të ketë një ndërmarrje sociale.



## Sfidat dhe Mundësitë për Punësimin e Grupeve të Marxhinalizuara nga NDËRMARRJET SOCIALE

Instrumentet e përdorur për mbledhjen e të dhënave (pyetësorët), në të dyja rastet si për ndërmarrjet sociale dhe për grupet e marxhinalizuara ishin pak komplekse dhe të gjatë, çka bëri që intervistat të ishin disi të gjata dhe pyetësorët kërkonin disa informacione specifike, të cilat të intervistuarit, në disa raste, kishin vështirësi t'i jepnin përgjigje.

Përsa i përket përcaktimit të kategorive të grupeve të marxhinalizuara ishte sfiduese pasi vende të ndryshme kishin kategorizime të ndryshme. Kampioni i personave të grupeve të marxhinalizuara është i vogël për të përfaqësuar popullatën e këtyre grupeve. Megjithatë, studimet e mëtejshme mund ta zmadhojnë kampionin, me qëllim bërjen e një përgjithësimi më të saktë të gjetjeve të studimit.



# Kapitulli 4

## Gjetjet

Në këtë kapitull janë përshkruar rezultatet e ndara në dy nënkapituj.

Kapitulli i parë ofron një përshkrim të të gjitha modeleve të ndërmarrjeve sociale dhe karakteristikave të tyre në Shqipëri dhe mundësitë që ato ofrojnë për punësimin e grupeve të marxhinalizuara.

Kapitulli i dytë ofron një analizë të të dhënave mbi grupet e marxhinalizuara, duke shqyrtuar në detaje situatën dhe vështirësitë me të cilat ata përballen në tregun e punës.

## GJETJET MBI NDËRMARRJET SOCIALE

Një nga pyetjet kërkimore konsiston në mbledhjen e informacionit të mjaftueshëm për të ilustruar dhe dokumentuar karakteristikat dalluese të të gjitha modeleve të NSve në Shqipëri. Ka katër dimensione kryesore që mund të kontribuojnë në kuptimin dhe analizën e diversitetit të modeleve të ndërmarrjeve sociale. Këto katër dimensione janë: **1) identiteti i përgjithshëm i ndërmarrjeve sociale, 2) natyra e misionit social, 3) qeverisja & struktura e pronësisë dhe 4) struktura financiare.** Një seksion tjetër i është shtuar pyetësorit lidhur me **punësimin e grupeve të marxhinalizuara nga NSTë.**


### Identiteti i përgjithshëm i ndërmarrjeve sociale (NSTë)

Në këtë seksion u mblodhën të dhëna mbi vitin e krijimit të NSsë, themeluesit dhe iniciatorët e saj, formën ligjore, llojin e njësisë institucionale, akreditimet/çertifikimet, numrin dhe përbërjen e forcës punëtore me kohë të plotë dhe të pjesshme, numrin e vullnetarëve që punojnë në ndërmarrjen sociale.

Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e NSve (60%) janë themeluar këto 5 vitet e fundit (2009-2014). Kjo tregon që NSTë janë një fenomen i ri në tregun shqiptar dhe ato janë ende në fazën e rritjes (**grafiku 1**). Sidoqoftë, ka një numër të konsiderueshëm NSsh (23%) që kanë një eksperiencë të gjatë në treg nga 11 deri në 20 vjet.




**Grafiku 1:** Vjetërsia e Ndërmarrjeve Sociale



Kategoritë kryesore të themeluesve ose iniciatorëve të NSve janë organizatat jofitimprurëse (28%), të ndjekura nga iniciativa personale (21%) ose një grup punonjësish (21%) (**grafiku 2**).

**Grafiku 2:** Themeluesit/Iniciatorët e Ndërmarrjeve Sociale




90% e NSve janë të regjistruara dhe kanë një formë ligjore të përcaktuar, ndërkohë që vetëm 3 nga 30 NS nuk ishin të formalizuara në vitin 2015, kohë kur është zhvilluar intervista.

Të dhënat tregojnë që pjesa më e madhe e NSve janë regjistruar si organizata jofitimprurëse (41%), që është forma tradicionale e NSve, ndërsa 26% janë regjistruar si person fizik, një formë ligjore e thjeshtë dhe me më shumë incentiva fiskale. Vihet re se një pjesë e konsiderueshme e kampionit (22%) janë organizata të regjistruara si shoqëri kursim kredi (SHKK)<sup>7</sup> dhe pjesa tjetër si shoqëri bashkëpunimi reciprok (11%) (grafiku 3). Sikurse vihet re nga të dhënat, brenda

7 Ligji Nr. 8782, datë 05/03/2001  
Shoqatat e kursim kreditit (SHKK) janë persona juridikë të përbëra nga unione vullnetarësh, personash fizik ose juridik që depozitojnë paratë e tyre në shoqatë dhe ato përdoren nga shoqata për të dhënë hua ndaj anëtarëve të shoqatës.

kampionit nuk ka asnjë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që vepron si NS. Edhe pse nuk ka një kuadër ligjor për ndërmarrjet sociale, forma ligjore e NSve në Shqipëri tregojnë që dy format më të spikatura ligjore janë: OJF dhe person fizik.


**Grafiku 3:** Lloji i formës ligjore të NSve



Nga vëzhgimi evidentohet se thuajse të gjitha NSTë nuk kanë akreditime ose çertifikime. Vetëm një prej ndërmarrjeve sociale ka një çertifikatë publike (Çertifikatë Eur 1, që shërben për transportin ndërkombëtar të mallrave).

Rezultatet nga të dhënat tregojnë që NSTë përgjithësisht funksionojnë si një njësi e vetme institucionale pa ndarje të tjera të decentralizuara (60%) (**grafiku 4**).


**Grafiku 4:** Decentralizimi i NSve



Ndërkohë të dhënat për numrin e fuqisë punëtore me kohë të plotë dhe të pjesshme ndihmojnë për të kuptuar potencialin për punësim pranë NSve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri. Duke iu referuar numrit të punonjësve me kohë të plotë, pjesa më e madhe e NSve (70%) deklarojnë një numër të ulët punonjësish që varion nga 0 në 5 (**grafiku 5**). Në përgjithësi, 60% e punonjësve me kohë të plotë në ndërmarrjet sociale janë femra.




**Grafiku 5:** Forca e Punës me Kohë të Plotë



Të dhënat tregojnë që pjesa më e madhe e NSve (70%) kanë 0-5 punonjës me kohë të pjesshme (grafiku 6). Vetëm “Fondacioni Rozafa” ka 108 punonjës me kohë të pjesshme. Kjo organizatë ka një eksperiencë në veprimtarinë dhe promovimin e ndërmarrjeve të vogla të drejtuara dhe të përbëra nga femra në Shqipëri, të cilat bashkëpunojnë për përmirësimin e kushteve të jetesës së grave të marxhinalizuara nga zona rurale dhe periferike, kryesisht në veri të vendit. Duke iu referuar aktivitetit të “Fondacionit Rozafa”, rezultojnë 98 femra që punojnë me kohë të pjesshme pranë këtij fondacioni. Përsa i përket përbërjes gjinore, rreth 78% janë femra kundrejt 22% meshkuj që janë të punësuar me kohë të pjesshme.

**Grafiku 6:** Forca e punës me kohë të pjesshme



Numri i vullnetarëve është një aspekt tjetër, i cili përcakton përbërjen dhe orientimin e NSve. Kryesisht ndërmarrjet sociale nuk kanë vullnetarë (47%), ndërsa 37% e NSve kanë 1-10 vullnetarë që punojnë 10 ose më shumë orë në muaj. Përsa i përket përbërjes gjinore, ka një përqindje pak më të lartë të femrave vullnetare (56%) krahasuar me meshkujt vullnetarë (44%).

Duke iu referuar numrit të vogël të punonjësve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, mund të arrihet në përfundimin se aktualisht NSTë në Shqipëri kanë një madhësi dhe kapacitet të vogël punësimi. Nga ana tjetër, rezultojnë se

gratë dhe vajzat përbëjnë grupin më të madh të punësuarve dhe të angazhuarve si vullnetarë në NS.

## Lloji i veprimtarisë dhe misioni

Lloji i veprimtarisë dhe misioni i NSve është dimension i dytë, i cili është themelor për të identifikuar dhe përcaktuar llojet e ndërmarrjeve sociale. Në këtë seksion është mbledhur informacion mbi misionin, traditat e misionit, grupet e targetuara dhe produktet/shërbimet që NSja ofron. Një komponent i rëndësishëm i studimit lidhet me inovacionin, nëse NSTë kanë sjellë një inovacion në treg dhe cilat janë format e inovacionit.

Ndërmarrjet sociale nuk janë shfaqur papritur, as nuk janë krijuar nga asgjëja. Ato kanë evoluar nga ndërthurja e disa traditave të gjera, secila nga të cilat mund të klasifikohet sipas një qëllimi kryesor të ndryshëm. Gjashtë (6) "traditat" historike të propozuara nga Mike Gordon (2015) përfaqësojnë qëllime dhe vlera kyçe të NSve:

**Qëllimi i përbashkët:** *Bashkëpunim dhe reciprocitet* - forma të vjetra të ndërmarrjeve sociale që kanë lindur nga iniciativa e shoqatave vullnetare dhe shtresa punëtore për të promovuar institucione ekonomike alternative, të kontrolluara nga vetë ata, për interesin, përfitimin dhe mbështetjen e tyre të përbashkët.

**Qëllimi komunitar:** *Shoqata komunitare dhe vullnetare* - zhvillim komunitar në një vendndodhje të caktuar gjeografike, bazuar në organizimin e sjelljes së shoqërisë në përgjithësi, përfshirjes së organizimit dhe kontrollit kolektiv.

**Qëllimi Altruist:** *Bamirësi dhe filantropi* - sektori "jo-fitimprurës", vullnetar, bamirës i përfshirë në përmirësimin e një ose më shumë fushash si: shëndeti i individëve dhe grupeve, arsimit, mirëqenia, ose zbutja e varfërisë.

**Qëllimi Etik:** *Ndryshimi dhe radikalizmi* - radikalizmi social dhe lëvizjet ekologjike alternative të "epokës së re" të bazuara në vlerat etike dhe më shumë në ndryshimin shoqëror radikal.


**Qëllimi i Tregut Privat:** *Biznesi dhe ndërmarrjet* - kryesisht e parë si kompetencë e sektorit privat, që i shërben nevojave individuale, të grupit ose dëshirave dhe përfitimit individual. **Qëllimi publik:** *Ndërmarrjet sociale publike* - rikonfigurim ose "eksternalizim" i shërbimeve publike në formën e organizatave të ndërmarrjeve sociale, me qëllimin e shprehur të përmirësimit dhe inovacionit në ofrimin dhe shpërndarjen e shërbimeve, por potencialisht dhe gjithashtu me qëllimin e limitimit të madhësisë së shtetit dhe reduktimin e shpenzimeve publike.

Studimi i NSve në Shqipëri tregon që traditat më të spikatura janë: qëllimet vullnetare dhe të komunitetit, qëllimet e përbashkëta dhe të tregut privat (**grafiku 7**). Traditat dominuese sipas misionit të NSve, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me themeluesit e ndërmarrjeve sociale. Duke iu referuar rezultateve të studimit, themeluesit tipikë të ndërmarrjeve sociale në Shqipëri janë grupe punonjësish, fermerësh, OJFsh, biznesesh private, të cilat kanë për qëllim bashkëpunimin dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve me fokus social duke targetuar një komunitet ose duke punuar për një qëllim të përbashkët.




# Sfidat dhe Mundësitë për Punësimin e Grupeve të Marxhinalizuara nga NDËRMARRJET SOCIALE

**Grafiku 7:** Traditat e lidhura me misionin e NSve



Të dhënat e mbledhura nga kampioni tregojnë specifíkisht grupet e targetuara nga NSTë. Një pjesë e kampionit targeton gjithë shoqërinë (27%), pra nuk ka një grup specifik të targetuar. Nga ana tjetër, në përputhje edhe me formën e tyre të regjistrimit dhe qëllimin e krijimit, ndërmarrjet sociale targetojnë fermerët (33%), biznesin e vogël (17%), gratë e papuna (13%) dhe të rinjtë e papunë (13%) (**grafiku 8**). Në përgjithësi, grupet e targetuara nëpërmjet misionit të NSve janë klientë ose punonjës të NSve.

**Grafiku 8:** Grupet e targetuara nga NSTë përmes misionit të tyre



Për të hulumtuar më tej në përbërjen e grupeve të targetuara nga NSTë, u mbledh informacion mbi grupmoshën dhe nivelin socio-ekonomik të grupeve të targetuara. Profili i moshës së këtyre grupeve konsiston kryesisht në grupmoshën 25-65 vjeç (47%) dhe të rinj të grupmoshës 18-25 vjeç (30%). Këto grupmosha lidhen ngushtësisht me llojin e grupeve kryesore të targetuara nga NSTë: fermerë, gra dhe të rinj.




Përsa i përket nivelit socio-ekonomik të grupeve të targetuara, NSTë kryesisht targetojnë nivelin e varfër dhe me të ardhura të ulëta (63%). Për shkak të nevojës për të gjeneruar të ardhura, 37% e NSve ofrojnë të mira dhe shërbime edhe për grupe të tjera me nivele të ndryshme socio-ekonomike.

Duke u thelluar më tej në studim, u vu re se njerëzit që jetojnë në një komunitet të caktuar si: minoritetet, fermerët (30%); njerëzit që jetojnë me barriera punësimi (18%) dhe aktorët lokalë ekonomikë (16%) përbëjnë tipologjitë më të spikatura të grupeve të targetuara nga SETë.

Fushat kryesore të veprimtarisë së NSve të intervistuar janë: prodhimi bujqësor (14%), trajnimi dhe konsulenca (14%) veçanërisht në fushën sociale. Gjithashtu depozitat/kreditë (14%) janë shërbimet kryesore të ofruara nga SHKKtë (grafiku 9).

**Grafiku 9:** Lloji i të mirave/shërbimeve që NSTë ofrojnë



Për të përmbushur qëllimin social, NSTë ofrojnë të mira dhe shërbime falas ose nën çmimin e tregut (58%). Ndërsa 17% e NSve, kryesisht SHKKtë ofrojnë të mira mbi çmimin e tregut. Kjo lidhet me mënyrën ndryshe të funksionimi të SHKKve. Ato marrin hua me interes më të vogël dhe i japin të klientët me interes më të lartë. Interesi është më i lartë në krahasim me bankat sepse dhe risku është më i madh në krahasim me sektorin bankar. Kështu, normat e interesit mbi huatë janë të vendosura mjaftueshëm të larta me qëllim që të ardhurat nga interesat të mbulojnë të paktën të gjitha shpenzimet financiare të SHKKsë.

Kim Alter (2007) propozoi llojet e mëposhtme të lidhjes së aktivitetit me misionin e SEve: 1) *aktiviteti me qëndër misionin*<sup>8</sup>, 2) *aktiviteti i lidhur me misionin*<sup>9</sup>,

8 **Aktivitate me qëndër misionin:** Aktiviteti bazohet në misionin social të organizatës. Aktiviteti zhvillohet për të përmbushur qëllimin social të organizatës.


9 **Aktivitate të lidhura me misionin:** Aktiviteti lidhet me misionin e organizatës. Aktivitetet e lidhura me misionin kanë sinerji dhe krijojnë si vlerë sociale për programet dhe gjenerim fitimi për të përmbushur misionin social të organizatës.



3) *aktiviteti jo i lidhur me misionin*<sup>10</sup>. Aktiviteti i NSve në Shqipëri është kryesisht me qendër misionin ose i lidhur me misionin (80%). 20% e NSve të intervistuar kanë aktivitete të pa lidhura me misionin e organizatës, qëllimi i vetëm i të cilave është gjenerimi i të ardhurave për të mbuluar kostot operative dhe shërbimet sociale që ofron, të cilat nuk i sjellin të ardhura të mjaftueshme. Ndërmarrjet sociale shpesh dalin jashtë fokusit të tyre për shkak të pamundësisë për të gjeneruar të ardhura vetëm duke përbushur dhe i qëndruar strikt misionit të tyre social. Ky fakt nuk është i lidhur me llojin e formës së organizatës (NSTë që kanë aktivitete të palidhura me misionin, të cilat variojnë nga SHKK, OJF dhe biznese).

Një nga pikat kyçe të identitetit të NSSë është aplikimi i inovacionit, i cili mund të jetë i formave të ndryshme. Vihet re se vetëm 50% e NSve të intervistuar aplikojnë inovacion. Duke iu referuar këtyre NSve, evidentohet se inovacioni aplikohet në nivel produkti (produkte ose shërbime që ofrohen për herë të parë në tregun shqiptar, produkte të ricikluara, produkt i ri), i ndjekur nga inovacioni i aplikuar në nivel organizativ (për shembull, përdorimi i medias sociale, si një mënyrë komunikimi me stafin njihet si formë inovatore) (**grafiku 10**).


**Grafiku 10:** Kategoritë e aplikimit të inovacionit



NSTë që aplikojnë inovacionin në nivel organizativ përfshijnë një gamë grupesh interesi në këtë proces. Në këtë rast, grupet e interesit janë punonjës (27%), të ndjekur nga vullnetarë (19%) dhe përdorues/klientë (16%) (**grafiku 11**).


10 *Aktivite jo të lidhura me misionin:* Aktiviteti nuk është i lidhur me misionin e organizatës, dhe as nuk ka qëllim avancimin e misionit në mënyra të tjera përveçse duke gjeneruar të ardhura për programet e veta sociale dhe kostot operative.

**Grafiku 11:** Grupet e interesit të përfshirë në inovacionin organizativ



Siç shihet në **grafikun 12**, NSTë aplikojnë inovacionin kryesisht për të arritur misionin e tyre dhe për të rritur gamën dhe cilësinë e produkteve/shërbimeve të ofruara (64%). Kjo lidhet me rezultatin e mësipërm që ndërmarrjet sociale e aplikojnë inovacionin kryesisht në nivel produkti.

**Grafiku 12:** Faktorët nxitës të inovacionit





## Qeverisja dhe struktura e pronësisë


Dimensioni i tretë që duhet të merret në konsideratë gjatë studimit të NSve ka të bëjë me mënyrën si qeverisen këto ndërmarrje, llojin dhe strukturën e pronësisë. Për këtë qëllim, NSTë u pyetën nëse janë pjesë e një grupi apo jo, nëse janë pjesë e një organizate mëmë, nëse kanë bord drejtorësh apo asamble të përgjithshme dhe cili është organizmi që ka pushtet më të madh vendim-marrës brenda organizatës. Gjithashtu, ndërmarrjet sociale u pyetën mbi opinionet dhe sfidat më të mëdha me të cilat përballen gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

60% e NSve të intervistuar kanë deklaruar se janë pjesë e një grupi, prej të cilave 47% janë OJF dhe 24% janë SHKK.

Rezultatet tregojnë që pjesa më e madhe e NSve që janë pjesë e një organizate mëmë janë SHKK (50%). Të gjitha SHKKtë janë pjesë e USHKKve, i cili shërben si një organizatë mëmë për të gjitha SHKKtë.


Përsa i përket formës së qeverisjes, shumica e NSve të intervistuar janë shoqata me anëtarësi (30%), të ndjekura nga SHKKtë (20%) (*grafiku 13*).

**Grafiku 13:** Forma e qeverisjes së NSve




Siç vihet re nga *grafiku 14*, në pjesën më të madhe të rasteve, organi vendim-marrës me peshë më të madhe në NS është një person i vetëm, me të njëjtën rëndësi me bordin e drejtorëve (35%). Kjo tregon që pushteti vendim-marrës është i përqëndruar në pak individ

**Grafiku 14:** Organi që ka pushtetin më të madh vendim-marrës



Siç shihet në **grafikun 15**, 37% e NSve nuk kanë asamble të përgjithshme dhe as bord drejtorësh. Kjo tregon që në ndërmarrjet sociale dominojnë struktura të thjeshta pronësie dhe jo shumë të konsoliduara. Po kaç NS (37%) kanë një formë pronësie me asamble të përgjithshme pa aksione. Duke iu referuar ndërmarrjeve sociale që kanë asamble të përgjithshme, grupet me më shumë ndikim në asamble janë punonjësit dhe vullnetarët. Ndërkohë NStë që kanë asamble me aksione (të cilat përbëjnë një numër shumë të vogël) vlerësojnë si një grup të rëndësishëm aksionerët individualë dhe e drejta e votës së aksionerëve bëhet bazuar në parimin “një anëtar, një votë”.

**Grafiku 15:** Lloji i strukturës së pronësisë dhe qeverisjes



Studimi tregon që vetëm 11 ndërmarrje sociale nga 30 janë pjesë e rrjeteve formale. Pjesëmarrja e vogël në rrjete tregon kapacitetin e vogël dhe mbështetjen e kufizuar që kanë ndërmarrjet sociale. Nga 10 rrjete të identifikuar, 4 prej tyre janë kombëtar, si: USHKK, Rrjeti i Artizanëve, Koalicioni Shqiptar për Fëmijët, Koalicioni BKTF, dhe pjesa tjetër janë ndërkombëtarë si: Microfinance Center, European Culture Parliament, New generation, COSPE, AVSI dhe Circle Alex Langer.



## Struktura financiare e NSve


Struktura financiare tregon kapacitetin aktual, por dhe potencialin që kanë NSTë për t'u zhvilluar. Për ta ilustruar këtë dimension janë mbledhur të dhëna mbi asetet totale të NSve, të ardhurat totale, burimet e të ardhurave, tendencat e të ardhurave totale vitet e fundit dhe nëse ka patur raste humbjesh apo fitimesh gjatë 3 viteve të fundit. Gjithashtu, është mbledhur informacion nëse NSTë përfitojnë nga incentivat financiare, cilat janë burimet e filantropisë, llojet e mbështetjes jomonetare, praktikat e përdorura për shpërndarjen e të ardhurave dhe mënyrat si shpërndahen asetet në rastet e likuidimit. Të dhënat financiare i referohen vitit fiskal 2014. Të dhënat janë mbledhur në monedhën vendase dhe janë konvertuar në Euro meqënëse studimi është pjesë e një iniciative rajonale.

Përsa i përket totalit të aseteve të NSve të marra në studim, vihet re një mungesë informacioni nga 20% e të intervistuarve. Sipas NSve të intervistuar, ka dy arsye për mos dhënien e këtij informacioni:

- NSTë nuk dëshirojnë të japin informacion;
- Përfaqësuesit e intervistuar të NSve nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi të dhënat financiare.

Shpërndarja e totalit të aseteve varion, por vihet re që pjesa më e madhe e NSve (33%) deklarojnë një total asetesh që varion nga 10,000-50,000 Euro, të ndjekura nga 20% e NSve që deklarojnë një total asetesh që varion nga 100,000-500,000 Euro. Ndërkohë 13% e NSve kanë një total asetesh nga 0-10,000 Euro (**grafiku 16**). Duke marrë në konsideratë faktin se mungon informacioni për një përqindje të konsiderueshme të NSve të intervistuar, është e vështirë të arrihet në një përfundim të saktë lidhur me kapacitetin financiar të NSve. Gjithsesi, bazuar në të dhënat e kufizuara mund të thuhet që kapacitetet financiare të NSve janë ende në nivele të ulta.


**Grafiku 16:** Asetet Totale



Më shumë se gjysma e NSve të intervistuar (56%) nuk kanë dhënë informacion mbi të ardhurat totale. 17% e NSve kanë deklaruar të ardhura totale që variojnë nga 1000 deri në 5000 Euro, të ndjekura nga 10% me të ardhura totale nga 0


në 1,000 Euro, dhe 10% që kanë të ardhura mbi 15,000 Euro. Pra, siç shihet nga **grafiku 17** ka një strukturë diverse të të ardhurave totale, të paktën për ato NS që kanë dhënë informacion.

**Grafiku 17:** Të Ardhurat totale në 2014



Shitjet në klientë apo subjekte private dhe publike përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave (37%), të ndjekur nga të ardhurat që vijnë nga aktiviteti filantropik (17%) (**grafiku 18**).

**Grafiku 18:** Burimi i të Ardhurave




Burimet monetare që vijnë nga filantropia zënë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të ndërmarreve sociale. Nga analiza e të dhënave burimet kryesore të filantropisë për NSTë janë: filantropi e drejtpërdrejtë nga qytetarët vendas, OJFtë dhe bizneset (28%) dhe fondacionet ndërkombëtare (24%). Pavarësisht



mungesës së incentivave dhe njohjes së aktivitetit filantropik, ky studim tregon edhe një herë se filantropia është një fenomen ekzistues në Shqipëri. Në një studim mbi zhvillimin e filantropisë në Shqipëri, raportohet aktiviteti i paqartë filantropik gjatë 20 viteve të fundit dhe theksohet se filantropia ka ekzistuar si fenomen që në shek e XIX, por nuk është dokumentuar si aktivitet as nga individët dhe as nga shteti (Partnerët Shqipëri, 2011)<sup>11</sup>.

Pjesa më e madhe e NSve (63%) përfitojnë mbështetje jomonetare. Llojet e mbështetjes jomonetare janë të ndryshme, por NSTë e intervistuarat përfitojnë kryesisht pajisje/makineri/kompjuterat (37%), trajnime falas (25%), të cilat janë të fushave të ndryshme dhe ndihmojnë në manaxhimin dhe ekzistencën e NSve. Një tjetër lloj mbështetjeje jomonetare që NSTë përfitojnë janë ndërtesat (18%), një ndihmë shumë e madhe për NSTë për të reduktuar kostot fikse (**grafiku 19**).

**Grafiku 19:** Llojet e mbështetjes jomonetare




Përsa i përket burimeve të mbështetjes jo monetare, kontribuesit kryesorë janë OJFtë (26%) fondacionet (15%), USHKK (15%). Unioni Shqiptar i Kursim Kreditit përbën një burim të rëndësishëm për mbështetjen jomonetare, duke qënë se është organizmi që mbështet të gjitha shoqëritë e kursim kreditit, të cilat përbëjnë një numër të konsiderueshëm në këtë kampion (**grafiku 20**).

11 Partnerët Shqipëri punon për promovimin e zhvillimit të filantropisë në Shqipëri që prej 2011 dhe monitoron aktivitetin filantropik në baza ditore dhe e raporton në baza mujore dhe vjetore. Për ta promovuar dhe mbështetur zhvillimit e kësaj tradite të vjetër dhe të vlefshme, Partnerët Shqipëri organizon për të pestin vit rradhazi ceremoninë e "Çmimit të Filantropisë", duke shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin për individët, familjet dhe subjektet që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës në shoqërinë tonë.




**Grafiku 20:** Burimet e mbështetjes jomonetare



Në qoftëse vëzhgohet tendenca në totalin e të ardhurave gjatë 5 viteve të fundit, mund të kuptohet dhe potenciali zhvillues i NSve nga pikëpamja financiare. Pjesa më e madhe e NSve përgjigjen pozitivisht, çka tregon se totali i të ardhurave ka pasur tendencë rritje (63%) (**grafiku 21**). Kjo tregon që NSTë disponojnë një potencial të mirë financiar për të ardhmen.

**Grafiku 21:** Trendi i të Ardhurave totale gjatë 5 viteve të fundit




Një pjesë e madhe e NSve (77%) nuk përfitojnë nga ndonjë përjashtim apo zbritje fiskale. Kjo tregon që vështirësitë ligjore dhe mungesa e nxitësve fiskalë janë pengesat kryesore me të cilat hasen NSTë.



## Sfidat dhe Mundësitë për Punësimin e Grupeve të Marxhinalizuara nga NDËRMARRJET SOCIALE

Po kështu një pjesë e NSve (48%) kanë regjistruar të ardhura neto gjatë 3 viteve të fundit, ndërkohë që 88% e NSve deklarojnë që nuk kanë patur humbje neto 3 vitet e fundit. Ky është një sinjal i mirë dhe mbështet analizën e mësipërme (**grafiku 22**), e cila tregon potencialin në rritje të NSve.


**Grafiku 22:** Të Ardhurat neto gjatë 3 viteve të fundit



**N=25**

NSTë e intervistuarua konsiderojnë se kanë arritur pak a shumë një nivel të përshtatshëm qëndrueshmërie financiare bazuar në misionin e tyre (**grafiku 23**). Kjo tregon që ka ende shumë për të bërë që NSTë të arrijnë një nivel optimal qëndrueshmërie financiare.

**Grafiku 23:** Niveli i përshtatshëm i qëndrueshmërisë financiare bazuar te misioni



**N=30**


Ndërmarrjet sociale përballen me shumë vështirësi në aktivitetin e tyre. Vështirësia kryesore e identifikuar nga NSTë që ndikon në qëndrueshmërinë financiare është mungesa e mbështetjes nga shteti (grante) dhe mungesa e incentivave financiare.

Në kushtet e një miksimi optimal të të ardhurave që ndërmarrjet sociale do të donin për të arritur një qëndrueshmëri financiare vihet re që NSTë nuk preferojnë të mbështeten vetëm në një burim financimi. Shitjet në subjektet private përbëjnë burimin më të dëshiruar të financimit, i cili do të sillte një strukturë më të diversifikuar financimi. 13% e NSve të intervistuar do të preferonin që 91%-100% e fondeve të vijë nga shitjet tek subjektet private e ndjekur nga 13% e NSve që do të preferonin që 11%-50% e buxhetit të tyre të vinte nga subjektet private (**grafiku 24**).

40% e NSve do të preferonin që 11-50% e fondeve të vijë nga grantet publike; 10% e NSve të intervistuar do të preferonin që 51%-90% e buxhetit të tyre të vinte nga grantet publike duke u ndjekur nga vetëm 3% që do donin që 91%-100% të ishin të ardhura nga investimet.

Burimet monetare nga filantropia dhe të ardhurat nga anëtarësimet janë më pak të preferuara nga NSTë, të cilat do të preferonin që këto të ardhura të zënë një pjesë të vogël në strukturën e financimit të NSve (0-10% të saj).


**Grafiku 24:** Struktura financiare optimale për organizatën



Një nga karakteristikat kryesore të NSve është praktika e shpërndarjes së të ardhurave. Siç shihet në **grafikun 25**, 78% e NSve në Shqipëri janë besnike të formës tradicionale të shpërndarjes së të ardhurave që është rinvestimi në ndërmarrje.



**Grafiku 25:** Praktikrat e shpërndarjes së të ardhurave neto në NS




Në mungesë të një legjislacioni specifik mbi krijimin dhe funksionimin e NSve, 50% e tyre nuk kanë rregulla mbi shpërndarjen e të ardhurave. Kështu, praktikrat e NSve janë joformale dhe përzgjedhja e praktikave të përdorura vendoset nga drejtuesit e ndërmarrjeve sociale. Sidoqoftë, gjysma e NSve kanë rregulla mbi shpërndarjen e të ardhurave totale. Rezultatet tregojnë që të gjitha SHKKtë kanë rregulla mbi shpërndarjen e të ardhurave. Arsyeja pse SHKKtë evidentohen mbi pasjen e rregullave është sepse të gjitha këto shoqata janë nën mbikqyrjen e Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë (Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë, 2005). Të gjitha SHKKtë dhe unionet e tyre janë të licënuara nga Banka e Shqipërisë.

Duke iu referuar NSve që kanë rregulla mbi shpërndarjen e të ardhurave, më poshtë renditen rregullat që ndërmarrjet sociale aplikojnë për shpërndarjen e të ardhurave:

- Shpërndarja është plotësisht e ndaluar (35%)
- Riinvestimi i të ardhurave totale (23%)
- E ardhura totale shpërndahet në mënyrë të barabartë midis anëtarëve të NSsë (12%)
- Lejohet vetëm shpërndarja e të ardhurave te organizata mëmë (12%)
- Rritja e kapitalit (6%)
- Shpërblimi i alokuar për aksion është subjekt i një limiti tavan (6%)
- 90% në depozita; 10% në kursimet e emergjencës (6%)


Po kështu për shkak dhe të një mungese kuadri ligjor, pjesa më e madhe e NSve (50%) kanë një mënyrë të papërcaktuar të rimbursimit, nëse një aksioner largohet (**grafiku 26**).

**Grafiku 26:** Mënyra si të rimbursohet kapitali nëse një aksioner largohet



Në raste likuidimi, mënyra si duhet të alokohen asetet është e papërcaktuar prej 27.5% të NSve dhe i njëjti numër ndërmarrjesh sociale ka një rregull mbi alokimin e aseteve midis anëtarëve (**grafiku 27**).

**Grafiku 27:** Alokimi i aseteve nëse NS vendos të likujdohet






## Punësimi i personave nga grupet e marxhinalizuara në NS

Një seksion i pyetësorit të ndërmarrjeve sociale konsiston në adresimin e pyetjeve të ndërmarrjet sociale për të kuptuar qasjen e NSve mbi integrimin dhe punësimin e grupeve të marxhinalizuara.

Ndërmarrjet sociale ofruan informacion mbi punonjësit që i përkasin grupeve të marxhinalizuara. Kategoritë e deklaruara nga NSTë janë paraqitur në **grafikun 28**. Vihet re që kategoria më e integruar në këto organizata janë personat e papunë me vështirësi ekonomike (38%), të ndjekur nga grupet minoritare (18%) dhe personat me aftësi të kufizuara (15%). Ndërmarrjet sociale që punësojnë persona të papunë deklaruan që numri varion nga 1 në 90 punonjës, ndërsa për grupet minoritare numri është i ulët dhe varion nga 1 në 2 punonjës. Analiza e të dhënave tregon që emigrantët, refugjatët, viktimat e trafikimit dhe dhunës seksuale dhe personat me sëmundje të rralla nuk janë të listuar në strukturën e punonjësve të ndërmarrjeve sociale.

**Grafiku 28:** Punonjësit nga grupet e marxhinalizuara



53% e NSve të intervistuar kanë pohuar që punësimi i grupeve të marxhinalizuara, kryesisht personat e papunë dhe në veçanti gratë<sup>12</sup> konsiderohen si prioritet për sa i përket punësimit të tyre. Arsyeja kryesore që konsiderohet si prioritet sipas NSve është që grupet e marxhinalizuara kanë nevojë më shumë se çdo individ tjetër për t'u punësuar. Ata shpjegojnë që kur personat e këtyre grupeve duan të punojnë dhe janë aktivë, dikush duhet të ofrojë një mundësi për ta. Drejtorët ekzekutivë të NSve mendojnë që ata mund t'i ndihmojnë këta persona, çka për rrjedhojë ka një ndikim më të madh sepse mund të sjellë ulje të varfërisë në vend.

12 "Gratë" nuk ishin klasifikuar si grup i marxhinalizur nga studiuesit gjatë kryerjes së studimit, por gjatë intervistave janë identifikuar si të tilla nga të intervistuarit, nën kategorinë "tjetër"

Gjithsesi, një përqindje të konsiderueshme (47%) zënë dhe NSTë që janë shprehur se punësimi i grupeve të marxhinalizuara nuk përbën një prioritet për ta, kryesisht sepse pozicionet e tyre të punës kërkojnë persona me aftësi të plota fizike dhe mendore dhe ata nuk kanë burime financiare për të punësuar staf shtesë. Një nga arsytet e dhëna është që punësimi i këtyre grupeve thjesht nuk është në fokus të këtyre ndërmarrjeve.

Për të hetuar më shumë mbi qasjen që NSTë kanë mbi punësimin e grupeve të marxhinalizuara, ato u pyetën mbi faktorët që i motivojnë për të punësuar këto grupe. Nga analiza e të dhënave, faktorët nxitës të shprehur nga NSTë mund të ndahen në dy kategori:

*Kategoria e parë* përfshin të gjithë faktorët nxitës të parë nga interesi i ndërmarrjeve sociale si: incentivat fiskale që qeveria mund t'u sigurojë në rast punësimi të personave nga grupet e marxhinalizuara dhe avantazhe në sigurimin e granteve nga donatorë të ndryshëm.

*Kategoria e dytë* përfshin të gjithë faktorët nxitës të parë nga këndvështrimi i përgjegjësisë sociale të NSve, si: dëshira për të zvogëluar diskriminimin që u bëhet këtyre grupeve, barazia dhe fuqizimi i grave, integrimi social dhe zhvillimi ekonomik që i sjellin vendit. Vetëm 3 organizata (SHKK Gjergjan, Casa nel Cuore dhe Qendra për Asistencë Teknike në Bujqësi) kanë pohuar se nxitën për të punësuar këta persona për shkak të kualifikimeve, profesionalizmit dhe aftësive që kanë disa prej këtyre personave. Një faktor interesant nxitës është theksuar nga Shoqata Kombëtare "Edukimi për Jetën" që në thelb të aktivitetit të saj ka edukimin dhe veçanërisht "edukimin në grup", ku të gjithë mund të mësojnë nga njëri-tjetri.

Një nga çështjet e rëndësishme, mbi të cilën janë mbledhur të dhëna është nëse grupet e marxhinalizuara trajnohen para se të fillojnë punë, një proces i zakonshëm i burimeve njerëzore për çdo punonjës të ri që rekrutohet. Nga të dhënat e mbledhura, vihet re që gjysma e NSve të intervistuarat i trajnojnë të rekrutuarit e rinj nga grupet e marxhinalizuara dhe pjesa tjetër nuk e aplikojnë trajnimin. Organizatat që ofrojnë trajnim për ta, deklarojnë se metoda më e përdorur e trajnimit është "trajnimi në punë", që nënkupton trajnimin e punonjësve përmes praktikës dhe në përputhje me punën që do të kryejë. Në varësi të llojit dhe aktivitetit të NSve, grupet e marxhinalizuara trajnohen mbi disa fusha të raportuara si: bujqësia, prodhimi i produkteve organike, artizanati, përdorimi i makinerive, etj. Disa organizata nuk ofrojnë trajnim vetëm mbi pozicionin specifik të punës, por dhe mbi shitjet, marketingun, strukturën e organizatës, procedurat e brendshme dhe funksionimin e organizatës në tërësi. Pra, trajnimi fokusohet edhe mbi njohuri të përgjithshme për organizatën apo departamentet e tjera. Pjesa tjetër e NSve shprehën se nuk mund t'i përballojnë financiarisht trajnimet dhe kjo është një arsye pse nuk i trajnojnë këta punonjës.

Gjithashtu, ndërmarrjet sociale sugjerojnë që trajnimet që u ofrohen grupeve të marxhinalizuara nuk duhet të jenë vetëm trajnime profesionale, por dhe mbi zhvillimin e kapaciteteve të tyre në tërësi. NSTë theksojnë faktin që kur nuk kanë mundësi për t'u siguruar trajnim këtyre grupeve, ata e delegojnë këtë proces tek



qendrat e formimit profesional, të cilat përgjithësisht e mundësojnë trajnimin falas ose me një çmim të reduktuar.

## **GJETJET MBI PERSONAT E PAPUNË NGA GRUPET E MARXHINALIZUARA**

Qëllimi kryesor i kësaj analize është të investigojë mbi dëshirën, motivimin dhe mundësitë e këtyre grupeve për t'u integruar në tregun e punës.

*Seksioni i parë prezanton të dhëna demografike rreth të intervistuarve si: gjinia, mosha, statusi civil, të ardhurat mesatare, përbërja e familjes.*

*Seksioni i dytë flet për punësimin e tyre, si rezultat i mbledhjes së të dhënave rreth viteve si të papunë, profesioni i të intervistuarve, nëse kanë dëshirë të punojnë në të ardhmen, arsyet e papunësisë, punët që mund të bëjnë të intervistuarit dhe nëse kanë nevojë për trajnim para se të fillojnë punën.*

*Seksioni i tretë fokusohet te rrethanat e jetës, pra vështirësitë që hasin në çdo fund muaji, nëse marrin ndihmë të çfarëdo lloji nga njerëz të tjerë, opinionin që kanë sesi mund t'i ndihmojë qeveria në kapërcimin e vështirësive.*

*Seksioni i fundit lidhet me përfitimet sociale dhe konkretisht me ndihmën ekonomike, pra nëse këta individë dhe familjarët e tyre marrin apo jo ndihmë ekonomike, opinionin e tyre për ndihmën ekonomike, procedurat e marrjes së saj si dhe dëshira për të marrë ndihmë ekonomike.*

### **Të dhënat demografike**


Përsa i përket përbërjes gjinore rezulton që kampioni i grupeve të marxhinalizuara është i përbërë nga 53 % femra dhe 47% meshkuj. 95% e tyre jetojnë në zona urbane dhe pjesa tjetër jetojnë në zona rurale.

Përsa i përket kategorive të grupeve të marxhinalizuara që marrin pjesë në këtë studim, siç mund të shihet nga grafiku 29, pjesën më të madhe të kampionit e zënë gratë e papuna (22%) dhe personat me aftësi të kufizuar (15%). Personat me aftësi të kufizuar janë pyetur rreth numrit të viteve që ata kanë me aftësi të kufizuar, e cila varion nga 12 vite deri në persona që kanë lindur me aftësi të kufizuar. Ndër personat e intervistuar me aftësi të kufizuar përfshihen: *të verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik.*

Mosha e kampionit varion nga 18-66 vjeç, por pjesën më të madhe (61%) e zë intervali nga 20-39 vjeç, pra grupmosha e të rinjve dhe të rriturve.




**Grafiku 29:** Kategoritë e grupeve të marxhinalizuara



Përsa i përket statusit civil të të intervistuarve (**grafiku 30**), pjesën më të madhe të kampionit e zënë të martuarit (52%) ndërsa 35% janë beqarë, dhe i përkasin kryesisht kategorisë së të rinjve.

**Grafiku 30:** Statusi Civil




Nga studimi rezultojnë që 65% e të intervistuarve kanë një familje të përbërë nga 2-4 persona. 26% e të intervistuarve kanë një familje me më shumë se 5 anëtarë, e gjendur kryesisht të romët dhe egjiptianët. 59% e kampionit ka fëmijë dhe pjesa më e madhe (86%) kanë 1 deri në 3 fëmijë.

Siç tregohet në **grafikon 31**, një përqindje e konsiderueshme e kampionit përbëhet nga individë që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe arsimin e lartë, respektivisht 27% dhe 22%. Vihet re që individët nga grupet e marxhinalizuara që janë të regjistruar në arsimin e lartë i përkasin kategorisë së të rinjve. Vlen për t'u përmendur si një shqetësim që 34% e personave nuk kanë arsimim, ose nuk kanë mbaruar arsimin fillor, të cilët i përkasin kryesisht kategorisë së personave



të pakualifikuar. Vihet re se papunësia te grupet e marxhinalizuara është e shpërndarë pavarësisht nivelit arsimor.

**Grafiku 31:** Arsimimi




Paga minimale bazuar në legjislacionin shqiptar është 22,000 lekë (Këshilli i Ministrave, 2015, p. 7), afërsisht 160 Euro. Në terma të të ardhurave mujore familjare, 47% e individëve nga grupet e marxhinalizuara në kampion kanë të ardhura mujore nën pagën minimale që një person duhet të paguhet, e cila thekson varfërinë në këto familje, çka është një problem shumë serioz. Ndërsa, 38% e të intervistuarve kanë të ardhura mujore që variojnë nga 160 deri në 300 Euro. Vetëm 3% kanë të ardhura mujore nga 500 deri në 600 Euro.

## Punësimi

Nga analiza e të dhënave vihet re se 32% e të intervistuarve nuk kanë punuar asnjëherë, ndërkohë që 58% hyjnë te të papunët afatgjatë pasi kanë nga 1 deri në 26 vjet të papunë. Kjo e dhënë përbën një problem, pasi papunësia afatgjatë çon në dekurajim të njerëzve për të kërkuar punë dhe në papunësi strukturore ku ka një mospërputhje afatgjatë të kërkesës me ofertën për punë.

Për më tepër, është vëzhguar se edhe individët që kanë qenë të punësuar më parë (48%) kishin një eksperiencë relativisht të shkurtër pune, respektivisht nga disa muaj deri në 5 vjet (**grafiku 32**).

**Grafiku 32:** Totali i viteve të punës



Personat, të cilët kanë patur eksperiencë pune më parë janë pyetur për punët që kanë bërë. Kryesisht punët e bëra nuk kanë kërkuar kualifikim apo arsimim të lartë, si: *punëtor ndërtimi, kujdestare fëmijësh, shitës, pastruese, peshkim, pjatallarës, kamarier, operator në call center*. Ndërkohë që disa prej tyre kanë qenë të angazhuar në zanate si: *mekanik, elektronik, parukeri, këpucar, artizanat, fotograf*. Të paktë janë ata që kanë pasur eksperiencë si: *arkëtar, dizenjator, asistentë në kompani, ekonomist dhe administrator*.

#### **Disa nga arsyet e humbjes së punës tek personat që kanë patur eksperiencë pune janë të listuara si më poshtë:**

- 51% e të intervistuarve e kanë humbur punën për shkak të *reduktimit të stafit dhe mbylljes/falimentit të kompanisë*.
- 15% e të intervistuarve e kanë humbur punën për shkak të *problemeve shëndetësore*, e vlefshme kjo kryesisht për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar.
- 13% e të intervistuarve që kishin rreth 20 vjet të papunë arsyeën e humbjes së punës i'a atribuojnë *tranzicionit nga komunizmi në demokraci*. Këta individë nuk kanë arritur të përshtaten me ekonominë e tregut dhe kërkesat e saj.
- 6% e personave të vetëpunësuar për shkak të *problemeve me lejet e ndërtimit nga ana e bashkisë*, si për shembull individë nga komuniteti rom dhe egjiptian që shisnin rroba të përdorura dhe nuk u lejuan ta vazhdonin më aktivitetin.
- 15% e personave të marrë në studim përmendin disa arsye të tjera si: *konflikte me stafin, largimi me dëshirë nga puna, arsye familjare, varësia nga droga dhe punë të përkohshme/sezonale*.



Nëse studion gatishmërinë për të punuar, si të individëve që nuk kanë punuar ndonjëherë si të atyre që kanë pasur një experience, vihet re se një shkallë e lartë prej 94% duan të fillojnë punë menjëherë. Kjo sipas tyre vjen për arsye ekonomike, ata kanë nevojë për të punuar që të plotësojnë nevojat e tyre bazë për jetesë. Ndërkohë, 6% e atyre që nuk janë të gatshëm të fillojnë punë shprehen se kanë arsye shëndetësore, të cilat nuk i lejojnë të punojnë.

Të gjithë të intervistuarit u pyetën për arsyet pse mendonin se ishin të papunë. Duke marrë në konsideratë arsyet dhe komentet e bëra nga të intervistuarit, është bërë një kategorizim i arsyeve të papunësisë, si më poshtë:

- 40% e të intervistuarve japin si arsye kryesore të papunësisë *mungesën e ofertës* (vendeve të reja të punës). Sipas tyre kjo mund të vijë si pasojë e politikave të gabuara të punësimin apo për shkak të rënies së ekonomisë.
- *Mungesa e kualifikimeve të vetë të intervistuarve* bën që të ketë një mospërputhje mes kërkesës dhe ofertës në treg. Kjo arsye pranohet nga 16% e kampionit.
- Një shqetësim i raportuar nga 15% e të intervistuarve është *diskriminimi* nga ana e punëdhënësit në shumë dimensione si: etnia, paaftësitë fizike, varësia nga drogat dhe mosha.
- 11% e të intervistuarve *fajësojnë shtetin, burokracitë, korrupsionin dhe domosdoshmërinë për të pasur lidhje politike, të afërm*, për të siguruar një punë në sektorin publik.
- 11% e të intervistuarve kanë pasur *probleme shëndetësore* (probleme me zemrën, aftësi të kufizuar) që i kanë ndaluar të punojnë.
- Një pjesë më e vogël (7%) vazhdojnë ende studimet në universitet dhe nuk kanë një punë.

Duke qënë se gatishmëria e këtyre individëve është e madhe për të punuar dhe për të hulumtuar më shumë mbi potencialin për t'u punësuar në të ardhmen, këta individë u pyetën mbi punët që ata janë të aftë të bëjnë. Rezultoni se përgjithësisht ata individë që kanë një eksperiencë nuk dalin jashtë fushës ku ata kanë punuar kur japin preferencat e punëve që do të bënin në të ardhmen. Ndërkohë që një pjesë e mirë e kategorisë së të rinjve, personave me aftësi të kufizuar dhe grave kanë përmendur punë që ata mund të bëjnë, të cilat janë konkretisht të lidhura me fushën e tyre të studimeve apo me zanate, të cilat mendojnë se i zotërojnë. Punët më të kërkuara nga këta individë janë *rrobaqepës, pastrues, roje, kopshtar, punonjës në ndërtim dhe banakier*.

Preferenca për të punuar në të njëjtën punë ku kanë eksperiencë mund të konsiderohet dhe si një barrierë punësimi për ta. Ka arsye të ndryshme, që e shpjegojnë këtë rezultat duke iu referuar rezistencës ndaj ndryshimit (Schuler, 2003; Forbes, 2012). Arsyet më të zakonshme pse njerëzit bëjnë rezistencë ndaj ndryshimit janë: frika nga e panjohura dhe ndryshimi i rutinës. Frika nga e panjohura i bën ata skeptikë dhe hezitues ndaj së ardhmes. Ndryshe, rutina i referohet zonave komforte. Pjesa më e madhe e njerëzve duan të jenë të sigurt dhe të qëndrojnë brenda zonës së tyre të komfortit. Kështu ata ndihen më të

sigurtë në qoftë se punojnë në fushën ku kanë eksperiencë. Një arsye tjetër e përmendur nga të intervistuarit është mungesa e kompetencave. Një punë ndryshe, kërkon të tjera aftësi dhe disa njerëz e ndjejnë se nuk do ta përballojnë mirë tranzicionin nga një punë në tjetrën.

Ajo çka vlen për tu theksuar është se të pyetur nëse kanë nevojë për trajnim, 75% e të intervistuarve përgjigjen se nuk e ndjejnë të nevojshme, pasi mendojnë se janë të aftë t'i kryejnë ato punë duke arsyetuar se kanë eksperiencë apo se kanë arsimimin e caktuar në atë fushë dhe nuk është e nevojshme të kryejnë trajnim. Mungesa e vullnetit të mirë për të përfituar nga trajnimi përbën një barrierë për punësimin e këtyre personave. Kjo vjen për faktin e mungesës së njohurive mbi trajnimin si proces dhe përfitimet që vijnë prej tij.

Ndërkohë, 25% e të intervistuarve (të rinj dhe gra) kanë shprehur se kanë nevojë për trajnim dhe kanë dëshirë dhe nevojë ta kryejnë trajnimin. Argumenti që mund të jepet se pse këto kategori e shohin si të nevojshëm trajnimin është se së pari, të rinjtë kanë nevojë për një orientim, pasi u mungon eksperiencia, pavarësisht se mund të kenë arsimin e duhur. Ndërsa gratë kanë zgjedhur përgjithësisht zanate, të cilat kanë nevojë paraprakisht për trajnim si: rrobaqepëse, parukiere, etj. Personat e gatshëm për të kryer trajnimin janë pyetur gjithashtu dhe nëse mund ta kryejnë trajnimin në çfarëdo rrethanash. Pjesa më e madhe përjashtojnë vetëm faktin nëse duhet të paguajnë sepse s'mund ta përballojnë dhe personat me aftësi të kufizuar shprehen se nëse do ju duhet të lëvizin në qytete të tjera nuk do ishin të gatshëm për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar.

Gjithashtu, për të hulumtuar më tepër në gatishmërinë për të punuar apo dhe preferencat e të intervistuarve janë pyetur nëse ka ndonjë punë specifike të cilën nuk do të mund ta bënin dhe ndonjë pagë minimale nën të cilën nuk do të punonin. 88% e tyre shprehen se mund të punojnë dhe nën pagën minimale të vendosur në legjislacion. Kjo përforcon konkluzionin e mësipërm, nevojën shumë të madhe që kanë këta individë për punë me qëllim përballimin e jetesës. Kjo mbështetet dhe nga fakti që 60% e tyre përgjigjen se mund të bëjnë çdo lloj pune që iu ofrohet.

Disa të intervistuar që kanë raportuar mbi punët që nuk preferojnë, kanë argumentuar përmes arsyeve të mëposhtme:

- Nuk mund të bëjnë punë që kërkojnë aftësi të plota fizike. Kjo përgjigje raportohet nga kategoria e personave me aftësi të kufizuar;
- Punët më pak të pëlqyera janë të kamarierit dhe banakierit, kjo kryesisht nga gratë dhe vajzat, të cilat shprehen se nuk mund t'i bëjnë për shkak të mentalitetit, apo për shkak të sjelljeve të papëlqyeshme të klientëve. Një grua nga komuniteti rom deklaroi se nuk mund të bëjë punë jashtë shtëpisë duke cituar: *"Nuk më lë bashkëshorti dhe vëzhri të punoj jashtë shtëpisë"*. Vihet re se forca e mentalitetit në disa grupe të marxhinalizuara është një arsye e rëndësishme që pengon gratë dhe vajzat të integrohen në punë.



## Kushtet e jetesës

Të pyetur për vështirësitë me të cilat këta individë përballen çdo muaj, ata japin disa nga përjetimet e tyre ku të gjithë pranojnë se *stresi, ngarkesa emocionale dhe herë pas here gjendja depresive* janë të pranishme çdo ditë pasi hasen me një sërë vështirësish ekonomike dhe sociale si:

- Rritja e fëmijëve dhe mos plotësimi i nevojave të tyre;
- Pamundësia për të shlyer borxhet;
- Pamundësia për të paguar të gjitha shpenzimet e nevojshme si: drita, ujë, qera, etj.;
- Pamundësia për të gjetur punë;
- Varësia financiare nga prindërit;
- Paragjykime në momentin që aplikojnë për punë (personat me aftësi të kufizuar).

Të pyetur se si i mbulojnë shpenzimet e tyre, të intervistuarit u shprehën se kryesisht me borxhe, me asistencën sociale dhe shumica e personave që jetojnë me prindërit shprehen se janë prindërit që i mbulojnë shpenzimet. Një pjesë përmendin se i mbulojnë shpenzimet nëpërmjet të ardhurave që vijnë nga një anëtar i familjes që punon, apo nga kursimet e mbledhura nga emigrimi.

Përsa i përket personit që merr vendimet se ku do shpenzohen të ardhurat, kjo është në varësi të përbërjes së familjes dhe personit që sjell të ardhurat në shtëpi. Në pjesën më të madhe vendosin prindërit (22%), dhe me po të njëjtën përqindje kolektivisht (22%), pra vendimi merret bashkarisht në familje.

Janë zhvilluar disa pyetje për të kuptuar nëse këta individë marrin ndihmë shtesë për të plotësuar nevojat e tyre. 82% e të intervistuarve mendojnë se kanë nevojë për ndihmë shtesë, por vetëm 15% prej tyre marrin ndihmë nga të tjerë. Ndihma që ata marrin konsiston në ushqim dhe veshje. Këto ndihma vijnë nga qendra dhe organizata jofitimprurëse, disa të përmendura si SFINX, Kryqi i kuq, nga xhamia dhe kisha. Të paktë janë rastet që deklarojnë se ndihma vjen nga të njohur.

Kur pyeten nëse ndihen mirë po të marrin dhurime, 66 % përgjigjen se ndihen mirë. Këta individë do të vlerësonin ndihmën nga kushdo që ka mundësi: njerëz, biznese, OJF. Por, kryesisht këta individë mendojnë se ndihma duhet t'u ofrohet nga shteti, sepse e mendojnë si detyrë të shtetit. Ndërsa personat që përgjigjen se nuk ndihen mirë po të marrin dhurim e arsyetojnë përgjigjen duke thënë se janë në gjendje të punojnë dhe pavarësisht papunësisë nuk duan ndihmë nga njeri, por vetëm në qoftëse shteti i ndihmon duke hapur vende pune.

Të pyetur sesi mund ti ndihmojë shteti, të intervistuarit shprehen se hapja e vendeve të reja të punës është kryesorja për ta, duke bërë të mundur integrimin e tyre në shoqëri. Disa nga kërkesat më specifike janë hapja e fabrikave, rrobaqepësive, ku këta persona mund të punësohen. Kategoria e të pastrehëve shprehet se shteti mund t'i sigurojë strehim dhe ushqim. Një alternativë e dhënë është që shteti të ofrojë një pako ushqimore për të gjitha familjet e grupeve të

marxhinalizuara. Individë nga komuniteti rom dhe egjiptian shprehen se kanë nevojë që shteti t'u mundësojë një treg ku mund të shesin rroba të përdorura dhe të jenë të lirë të përfitojnë nga ky burim të ardhurash. Gjithashtu, të intervistuarit shprehen se ilaçet duhet t'u ofrohen me një çmim më të lirë këtyre grupeve, që ta bëjë më të përballueshme jetesën e tyre.

Përsa i përket arsyeve pse nuk janë ndihmuar ende, këta individë shprehen se nuk i njohin arsyet, por disa nga arsyet që përmendin si të mundshme janë: diskriminimi ndaj këtyre shtresave dhe mungesa e interesit për ta.

## Përfitimet sociale

Përsa i përket përfitimeve sociale që marrin personat e grupeve të marxhinalizuara nuk ka të dhëna të qarta dhe të mjaftueshme zyrtare, ndaj u zhvillua një intervistë me specialistë nga departamenti ligjor i Shërbimit Social Shtetëror. Përveç intervistës, të dhënat lidhur me përfitimet sociale të mbledhura nga intervistat e kampionit të marrë në studim i dhanë një qasje më të gjerë studimit. Një nga çështjet e adresuara lidhet me grupet e marxhinalizuara që përfitojnë ndihmë ekonomike sipas legjislacionit (Këshilli i Ministrave, 2005). Kategoritë që përfitojnë ndihmë ekonomike<sup>13</sup> janë:

- Gratë e dhunuara dhe viktimat e trafikimit, që përveç shërbimit të ofruar, marrin 3000 lekë në muaj;
- Jetimët, të cilët marrin 3000 lekë në muaj;
- Personat me aftësi të kufizuar, të cilët marrin nga 6800 deri në 21000 lekë në muaj (21000 lekë/muaj për ata të cilët ndjekin arsimin e lartë apo studimet pasuniversitare me ose pa shkëputje nga puna, si dhe kanë mbrojtur gradë shkencore) (Këshilli i Ministrave, 2006);
- Familjet me dy ose më shumë fëmijë në të njëjtën kohë;
- Familjet e varfëra, ku të gjithë anëtarët e familjes të aftë për të punuar janë të papunë. Ndihma ekonomike në këto raste varion nga 700 deri 8000 lekë. Kjo varet nga përbërja e familjes dhe të ardhurat e tyre. Në qoftë se anëtari i një familje është i punësuar dhe paga e tij/saj është mbi 8000 lekë, atëherë institucioni përgjegjës ka të drejtë ta ndërpresë ndihmën ekonomike.

Lloji i ndihmës që ky institucion u jep këtyre grupeve është ndihmë e pjesshme (ndihma ekonomike është e pjesshme kur individët kanë tokë bujqësore ose bagëti, por të ardhurat e tyre janë më pak se 8000 lekë) dhe ndihmë e plotë, kur familja nuk ka burime të ardhurash. Viktimat e dhunës dhe jetimët marrin gjithashtu shërbim social përveç mbështetjes financiare.

Sipas informacionit të marrë nga intervista me përfaqësuesen e Shërbimit Social Shtetëror, ky institucion ka korrespondencë me të gjitha zyrat lokale dhe autoritet publike (siç janë Zyrat e Punës) që kanë përgjegjësi për secilin

13 Ndhimë ekonomike është shuma e parave që iu jepet personave në nevojë (kategoritë e listuara më sipër) sipas VKM Nr. 787/2005 Për Përcaktimin e Kriterëve, Procedurave dhe të Masës së Ndhimës Ekonomike.



nga kriteret që institucioni kërkon të verifikojë me qëllim që pasi këto kriteret të përmbushen të japë ndihmën ekonomike. Duke iu referuar procedurave, përfaqësuesja e institucionit shpjegoi se periudha e përfundimit të procedurave mund të zgjasë deri në një muaj, sepse këshilli vlerësues mbledhet vetëm një herë në muaj. Dokumenti që kërkon më shumë kohë sipas të intervistuarës është certifikata e pronësisë dhe kjo është arsyeja pse pjesa më e madhe i vlerësojnë si burokratike këto procedura. Institucioni është duke përgatitur një sistem pilot, i cili do të përdoret të dhëna të kryqëzuara dhe deklarimet do të bëhen përmes sistemit. Kur një person nuk është më pjesë e skemës dhe ai/ajo vendos të marrë përsëri ndihmën ekonomike, procedurat do të jenë të njëjtat pa pengesa të tjera.

Përveç të dhënave nga Shërbimi Social Shtetëror, u mblodhën të dhëna primare edhe nga intervistat me grupet e marxhinalizuara mbi këtë çështje, pra nëse merrnin ndihmë ekonomike, shuma që merrnin, opinionin i tyre mbi skemën, si i vlerësonin procedurat e marrjes së ndihmës ekonomike dhe arsyet pse këta persona donin ta përfitonin këtë ndihmë.

Nga të intervistuarit vihet re se vetëm 16% marrin aktualisht ndihmë ekonomike, ndërkohë që një përqindje më e lartë (24%) kanë qënë të përfshirë në sistemin e ndihmës ekonomike të paktën njëherë, ndërkohë që 8% prej tyre iu është ndërprerë ndihma gjatë 5 viteve të fundit. Arsyeja e ndërprerjes së ndihmës ka qënë për shkak të mosplotësimit të kushteve që kërkon marrja e ndihmës sociale si - futja në punë e një familjari, emigrimi jashtë shtetit apo blerja e një makine.

Rreth 84% e personave që aktualisht nuk përfitojnë ndihmë ekonomike shprehen se dëshirojnë ta përfitojnë, për shkak se kanë nevojë për një burim të ardhurash, pavarësisht se është e vogël. Por, e theksojnë se nëse do gjenin punë do ishte më mirë. Ndërkohë kategoria e personave që shprehen se nuk do donin të përfitonin ndihmë ekonomike e arsyejnë duke thënë se do donin të kishin një punë dhe të ndjeheshin të përgjegjshëm dhe të angazhuar sesa thjesht të merrnin ndihmën ekonomike.

67% e të intervistuarve shprehen se marrin një shumë të vogël ndihme, e cila varion nga 3000 në 9000 lekë çka e bën shumë të vështirë jetesën e tyre të përditshme.

Opinionin e të intervistuarve mbi ndihmën ekonomike si për ata që marrin aktualisht dhe për ata që nuk marrin bashkohet në një pikë që *ndihma ekonomike është e ulët dhe nuk arrin të mbulojë nevojat e një familjeje*. Të intervistuarit vënë në dukje dhe një problem tjetër, atë të vonësive në marrjen e ndihmës, çka përbën një problem madhor për këto familje. Gjithashtu, theksohet prej tyre se ndihma ekonomike duhet t'i jepet vetëm individëve që kanë nevojë dhe jo të abuzohet siç ka ndodhur në disa raste.

Rreth 67% e tyre shprehen se nuk kanë frikë nga ndërprerja e ndihmës ekonomike në rast se punësohen pasi pagesa e ndihmës ekonomike është shumë e vogël, krahasuar me pagën që mund të marrin nëse punësohen. Por, ka dhe një pjesë që ndihen të frikësuar (33%) (kryesisht kategoria e personave me aftësi të kufizuara) për shkak se ndihma ekonomike është i vetmi burim për ta dhe në qoftë se ndërpritet do ishte një problem i madh ekonomik dhe shoqëror



për këto familje, çka rrjedhimisht do reflektohej në shoqëri. Personat me aftësi të kufizuar janë më të frikësuar sepse ata janë kategoria më e pafavorizuar dhe me më pak shanse dhe mundësi për t'u punësuar.

Të pyetur për procedurat e marrjes së ndihmës ekonomike, pjesa më e madhe shprehen se procedurat janë burokratike dhe dokumentat kushtojnë shumë për t'i bërë, ndërkohë që një pakicë prej tyre shprehen se procedurat janë të rregullta dhe të nevojshme për të vërtetuar statusin që kanë. Përsa i përket kohës që marrin procedurat ato shkojnë deri në 1 muaj sipas të intervistuarve, e refletojnë kjo dhe nga intervista me përfaqësuesen e Shërbimit Social Shtetëror.

Për të kuptuar më tepër rreth dëshirës së grupeve të marxhinalizuara për të punuar, apo për të marrë ndihmën ekonomike, të intervistuarit u pyetën sesa dakort ishin me pohimin e njerëzve që *ata që përfitojnë ndihmë nuk duan të punojnë*. Rezultoi se 99% e të intervistuarve nuk janë dakort me këtë pohim. Pjesa më e madhe pranon që ky është një paragjykim i njerëzve dhe se personat që shprehen në këtë mënyrë kanë një perceptim të gabuar. Ata e justifikojnë mosdakortësinë me këtë pohim me arsyen se ndihma ekonomike është shumë e vogël dhe nuk arrin t'i përmbushë nevojat, kështu që patjetër është e nevojshme puna, jo vetëm financiarisht por dhe intelektualisht. Gjithashtu puna ndihmon në integrimin social të punonjësve.

Personat e intervistuar u pyetën sesi mund të përmirësonin sistemin e ndihmës ekonomike. Një rekomandim kryesor që jepet nga përgjigjet e tyre është rritja e shumës së ndihmës ekonomike, me qëllim që njerëzit të mund të përballojnë shpenzimet mujore dhe rritjen e çmimit të të mirave dhe shërbimeve në treg. Gjithashtu, ata theksojnë faktin e krijimit të një sistemi të drejtë të ndihmës ekonomike, çka nënkupton që ndihma ekonomike duhet ti jepet vetëm personave në nevojë, siç përcaktohet në legjislacion. They were asked how they could improve the economic assistance system. One common recommendation was to increase the economic assistance amount, so that people can afford the minimum monthly expenses and the increasing price of goods and services in the market. In addition, they emphasize the establishment of a fair economic assistance system, which means distributing economic assistance only to persons in need, as prescribed by the legislation.



# Kapitulli 5

## Diskutim dhe Konkluzione

Së pari, për të shqyrtuar mundësitë që kanë NSTë për të punësuar grupet e marxhinalizuara u realizua një profil i plotë i SEve, duke u mbështetur në disa dimensione me qëllim që të zbulohet potenciali dhe qëndrueshmëria e tyre. Së dyti, u hulumtua më thellë në situatën e grupeve të marxhinalizuara, jo thjesht për të kuptuar nivelin e tyre socio-ekonomik, por për të ditur nëse ekziston gatishmëri dhe vullnet nga ana e këtyre grupeve për t'u punësuar, apo preferojnë më shumë të përfitojnë nga ndihma ekonomike. Si përfundim nga studimi kanë dalë mundësitë që mund t'i ofrojnë SETë grupeve të marxhinalizuara në Shqipëri dhe sfidat që hasin dhe i pengojnë këto sipërmarrje në integrimin e këtyre kategorive në punë.

## PROFILI I NDËRMARRJEVE SOCIALE

Pas hulumtimit të zhvilluar në këtë studim, u arrit të bëhej një hartëzim dhe profil i SEve që veprjnë në Shqipëri i parë në katër dimensione kryesore: 1) *identiteti i përgjithshëm*, 2) *natyra e misionit social*, 3) *struktura financiare dhe* 4) *struktura e qeverisjes dhe e pronësisë*.

Së pari vihet re se nga 30 NS të marra në studim, përsa i përket identitetit të përgjithshëm të tyre, pjesa më e madhe janë krijuar këto vitet e fundit dhe madje 3 nga NSTë nuk ishin formalizuar ende në momentin që u zhvilluan intervistat. Pra, NSTë janë një fenomen i ri në treg dhe janë në fazën e rritjes përsa i përket ciklit të jetës të organizatës. Përgjithësisht nuk kanë akreditime apo certifikime dhe kjo lidhet me mungesën e një legjislacioni mbi NSTë. Duke mos pasur një legjislacion dhe rregullore për këto forma sipërmarrje është e vështirë që të ketë dhe mekanizma apo organizma certifikues apo akreditues, të cilët të njohin dhe vlerësojnë cilësinë e produkteve/shërbime apo dhe qëndrueshmërinë e tyre. Pjesa më e madhe e themeluesve të NSve janë organizata jofitimprurëse, kjo sepse funksionimi si OJF, por dhe me të drejtën që të jep ligji "Për Organizatat Jofitimprurëse" (Fletorja Zyrtare, 2001) për të ushtruar aktivitet ekonomik, ka bërë që pjesa më e madhe e NSve të funksionojnë në këtë mënyrë. Megjithatë ka një numër NSsh (42% gjithsej) që janë krijuar nga iniciativa personale dhe grupe

punonjësish.

Format tipike me të cilat janë regjistruar NSTë siç u përshkrua më lart janë OJFtë (që është forma tradicionale e NSve); të ndjekura më pas nga forma e personit fizik (duke qënë se është një nga format juridike që ka më shumë lehtësira nga ana fiskale); Shoqëritë e Kursim Kreditit (përkufizimi i të cilave është dhënë më lart) (Fletorja Zyrtare, 2001); dhe Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor. Numri i punonjësve është i vogël dhe varion nga 0-5 punonjës me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme për 70% të NSve. Përsa i përket përbërjes gjinore, gratë dominojnë si forcën e punës me kohë të plotë dhe më kohë të pjesshme. Po kështu, pjesa më e madhe e NSve nuk kanë vullnetarë.

NStë funksionojnë kryesisht si entitet i vetëm, pa nënndarje të tjera. Më shumë se gjysma e NSve janë pjesë e një grupi apo organizate ombrellë dhe përgjithësisht këto janë OJF apo SHKK. Forma e qeverisjes varion kryesisht nga OJF me anëtarësi (shoqata), në SHKK dhe organizata pa aksione. Përsa i përket organizmave që kanë fuqinë vendimmarrëse, bordi i drejtorëve dhe vendimmarrja me një individ të vetëm zënë të njëjtën peshë, çka tregon se autoriteti është i përqëndruar kryesisht në pak njerëz. Dy tipet kryesore të strukturës së pronësisë janë NS pa aksione dhe pa Bord dhe NS me Asamble të Përgjithshme, por pa aksione.

Përsa i përket grupeve që targetojnë NSTë nëpërmjet misionit të tyre kryesisht janë fermerët dhe kjo pasi një pjesë janë shoqëri të bashkëpunimit bujqësor; gratë e papuna, të rinjtë dhe shoqëria në tërësi (pra kanë një mision, i cili prek një target grup të gjerë si shoqëria). Për rrjedhojë, mosha e grupeve të targetuara janë të rinj (18-25 vjeç) dhe të rritur (25-65 vjeç) dhe niveli socio-ekonomik është kryesisht ai i varfër dhe me të ardhura të ulëta. Megjithatë ka një numër NSsh që targetojnë të gjitha nivelet socio-ekonomike, pra e zgjerojnë gamën me qëllim gjenerimin e të ardhurave të mjaftueshme. Grupet e targetuara nëpërmjet misionit janë kryesisht klientët dhe punonjësit.

Fusha e veprimtarisë ku veprojnë NSTë është shumë diverse dhe pjesa më e madhe janë në fushën e prodhimeve bujqësore, trajnime dhe konsulencë (kryesisht e ofruar nga OJFtë) dhe depozitat/kreditë (shoqëritë e kursim-kreditit). Fusha të tjera veprimtarie janë tregtia, produktet artizanale, shërbimet e edukimit, produktet ekologjike, shërbimet turistike, veshje/aksesorë, evente kulturore, dhënie me qera, transport mallrash, ushqime dhe shërbime komunitare. 80% e SEve e kanë të lidhur aktivitetin e tyre me misionin. Por ekziston dhe një pjesë tjetër (20%), aktiviteti i së cilave është i pa lidhur me misionin, pra NSTë dalin jashtë fokusit të tyre me qëllim gjenerimin e të ardhurave në pamundësi për të gjeneruar të ardhura duke i qëndruar strikt misionit të tyre social. Përgjithësisht, pjesa më e madhe e SEve i ofron produktet apo shërbimet falas ose më lirë se çmimi i tregut, me rastin përjashtimor të SHKKve që i ofrojnë kreditë me çmim më të lartë se bankat, dhe kjo vjen për shkak se risku i tyre është me i lartë se institucionet e tjera kredidhënëse. Vetëm gjysma e NSve zbatojnë inovacion dhe kryesisht në nivel produkti. Kryesisht këto NS e zbatojnë inovacionin për të arritur misionin apo për të rritur gamën e produkteve dhe shërbimeve që ofrojnë.

Përsa i përket strukturës financiare dhe të dhënave financiare ajo çka vihet re është se një pjesë e konsiderueshme nuk japin informacion kur pyeten mbi totalin



e aseteve dhe një numër akoma më i madh NSsh (56%) nuk ofron informacion mbi totalin e të ardhurave. Megjithatë, nga të dhënat financiare shihet se NSTë kanë një kapacitet të vogël, pasi 46% deklarojnë asete nga 0-50,000 Euro. Po kështu përsa i përket të ardhurave, 34 % deklarojnë të ardhura deri në 15,000 Euro. Megjithatë këto NS kanë potencial për t'u rritur, pasi pjesa më e madhe deklarojnë se të ardhurat totale kanë një trend rritës këto 5 vitet e fundit, dhe po kështu pjesa më e madhe nuk kanë përjetuar humbje neto vitet e fundit.

Llojet e të ardhurave vijnë kryesisht nga shitjet te klientë privatë ose publik. Një burim të ardhurash për NSTë janë dhe të ardhurat nga filantropia që vijnë kryesisht nga qytetarët, OJFtë, subjektet private dhe fondacionet ndërkombëtare. Pjesa e madhe e NSve pranojnë se marrin ndihma jo monetare që janë kryesisht të llojit të ndërtesave, pajisjeve/makinierive/kompjuterave (çka ndihmojnë shumë në uljen e kostove fikse të NSve), apo dhe trajnime në lidhje me fusha të ndryshme. Pjesa më e madhe vlerësojnë si pengesë përsa i përket gjendjes financiare mungesën e mbështetjes nga ana e shtetit me grante dhe mungesën e lehtësirave fiskale.

Përsa i përket praktikave të shpërndarjes së të ardhurave, NSTë në Shqipëri zbatojnë kryesisht praktikën e riinvestimit në sipërmarrje të të ardhurave, veçori tipike e modelit të NSve. Megjithatë vetëm gjysma e NSve kanë rregulla mbi shpërndarjen e të ardhurave, dhe ato janë kryesisht SHKK. Kjo vjen për një arsye të thjeshtë se SHKKtë janë të supervizuara dhe të rregulluara nga një mekanizëm mbikqyrës, që është Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë (2005). Për shkak të mungesës së kuadrit ligjor dhe rregullore, pjesa më e madhe e NSve kanë një mënyrë të papërcaktuar si duhet të shpërndahen aksionet në qoftë se një aksioner largohet, apo si duhet të shpërndahen asetet në rast likuidimi të NSve.

Përsa i përket punësimit të grupeve të marxhinalizuara, vihet re se grupet e punësuarra më shumë nga ana e NSve janë të papunët me vështirësi ekonomike, të ndjekur nga minoritetet dhe personat me aftësi të kufizuar. Më shumë se gjysma e NSve pranojnë se punësimi i grupeve të marxhinalizuara dhe kryesisht të papunët janë prioritet për NSTë. Arsyet pse NSTë duan të punësojnë këta individë janë të ndryshme që variojnë nga pragmatiste, si përfitimi i lehtësirave fiskale, përfitimi i fondeve nga donatorët dhe deri në ata që mendojnë se këta punonjës janë aset, dhe duke i punësuar ndihmojnë jo vetëm ata por dhe gjithë shoqërinë. Por ekzistojnë dhe ato NS që nuk punësojnë grupe të marxhinalizuara duke shprehur se nuk i kanë prioritet, apo se nuk mund të punësojnë persona me aftësi të kufizuar, pasi punët që ofrojnë kërkojnë aftësi të plota mendore dhe fizike. Gjithashtu, disa theksojnë se mundësitë e tyre financiare janë të ulta çka bën që mos të kenë mundësi për të punësuar staf shtesë.

Pra, si përfundim mund të thuhet se format ligjore si në shumë vende të botës, Franca, Belgjika etj. variojnë por kryesisht janë OJF, SHKK, shoqëri bashkëpunimi reciprok dhe person fizik. NSTë në Shqipëri plotësojnë një nga tiparet kryesore që identifikon NSTë që është riinvestimi i të ardhurave përsëri në organizatë dhe gjysma prej tyre zbatojnë inovacion kryesisht në nivel produkti/shërbimi. Një tjetër karakteristikë e NSve në Shqipëri që përshtatet dhe me përkufizimet e dhëna në literaturë është se pjesa më e madhe janë të udhëhequra nga misioni

dhe aktiviteti i tyre është i lidhur me misionin.

Në përgjithësi ka disa fakte si: grupet e targetuara, niveli socio-ekonomik i personave që u shërbejnë, çmimi me të cilin e ofrojnë produktin/shërbimin, të cilat përforcojnë të dhënat që NSTë në Shqipëri kanë kryesisht qëllim social, por nuk mungojnë dhe ato NS që janë të orientuara nga aktiviteti tregtar. Modeli i NSve të orientuara nga aktiviteti tregtar identifikohet pasi i shërbejnë një target grupi më të gjerë me produkte/shërbime, çmimet e produkteve/shërbimeve mund të jenë sa çmimi i tregut apo dhe më shumë, fusha e aktivitetit nuk ka domosdoshmërisht ndikim social dhe është e lidhur me misionin, si dhe nuk e kanë prioritet punësimin e shtresave në nevojë.

## SITUATA E GRUPEVE TË MARXHINALIZUARA

Nga të gjitha kategoritë e grupeve të marxhinalizura të analizuar në këtë studim, pjesën më të madhe e zënë gratë dhe personat me aftësi të kufizuar. Grupmosha mbizotëruese janë të rinj dhe të rritur. Pjesa më e madhe janë të martuar dhe me fëmijë, pra janë kryefamiljarë. Shumica e të intervistuarve janë pa arsim apo pa mbaruar shkollën fillore (34%), të ndjekuar nga personat me arsim të lartë (27%). Më shumë se gjysma janë të papunë afatgjatë (1-26 vjet) me një eksperincë të pakët pune pak muaj deri në 5 vjet, çka tregon vështirësinë e tyre për t'u punësuar, pasi këto të dhëna sjellin papunësinë strukturore dhe një mospërputhje të kërkesës me ofertën. Ndërkohë, 32% e të intervistuarve nuk kanë punuar ndonjëherë. Pra, që të konsiderohen si punonjës potencialë, këto grupe duhen trajnuar para se të integrohen në tregun e punës. Të ardhurat në familjet e këtyre grupeve për 47% janë nën pagën minimale të vendosur nga shteti që duhet të marrë një person i vetëm. Përsa i përket arsyeve të humbjes së punës ato më kryesoret janë reduktimi i stafit, çështjet shëndetësore, apo mbyllja e fabrikave që në kohën e komunizmit dhe pamundësia e integritimit në punë me ardhjen e demokracisë dhe ekonomisë së lirë të tregut.

Arsyet e papunësisë, këta persona ia atribuojnë mungesës së vendeve të lira të punës, dhe kjo për shkak të politikave të gabuara të shtetit; diskriminimit për shkak të etnisë, paaftësisë dhe moshës; mungesës së kualifikimit të tyre; problemeve shëndetësore dhe domosdoshmërisë për të pasur lidhjet politike të duhura për të depërtuar në treg apo për t'u punësuar në administratën publike.

Këta persona deklarojnë se stresi, ngarkesa emocionale dhe në disa raste depresioni janë pjesë e jetës së tyre duke qënë të paaftë për të përmbushur nevojat vetjake të jetesës dhe të familjes. Vështirësitë sociale dhe ekonomike variojnë nga pamundësia për të rritur fëmijët, për të shlyer borxhet, vështirësia për të paguar shpenzimet bazë, si drita, ujë, qera. Të rinjtë ndjejnë dhe një ngarkesë për shkak të varësisë financiare nga familjet e tyre dhe kjo vjen si pasojë e mungesës së punës. Të gjithë shprehen se mënyra sesi e përballojnë jetesën është me borxhe, me pagën e një personi, me kursimet që nga koha që kanë qënë emigrantë jashtë Shqipërisë apo dhe me reminitancat që iu vijnë nga të afërt që mund të kenë jashtë vendit. Pjesa më e madhe shprehen se kanë



nevojë për mbështetje qoftë dhe jo monetare, por të paktë janë ata që marrin një mbështetje të tillë. Personat që përfitojnë nga donacionet shprehen se këto vijnë nga kisha, xhamia, shoqatat dhe shumë pak nga të afërm.

Vetëm 16% e të intrvistuarve nga grupet e marxhinalizuara, përfitojnë ndihmë ekonomike, por të gjithë pranojnë se ndihma që marrin nuk mjafton për të përmbushur nevojat e tyre për jetesë. Pjesa më e madhe shprehet se ka procedura burokratike dhe ndodh që asistenca të vonohet dhe mos të jepet në kohë, çka është shumë problematike për ta. Ajo çka vihet re është se të gjithë, si personat që marrin aktualisht, ashtu edhe ata që kanë marrë më parë ndihmë ekonomike por dhe të tjerët shprehen unanimitisht se do donin më shumë të punonin sesa të merrnin ndihmë ekonomike. Arsyet që ata japin lidhur me këtë gjykim është se puna jo vetëm të ofron të ardhura më të larta por dhe të jep mundësi për t'u integruar në shoqëri.

Për të parë fushat e punës ku mund të punësohen këta individë, u pyetën në lidhje me punët që do donin të bënin në të ardhmen. Vihet re se personat që kanë patur një eksperiencë të mëparshme kërkojnë të bëjnë të njëjtat punë, dhe personat me një arsimim të caktuar kërkojnë të punojnë në fushën e tyre të studimit. Punët më të kërkuara janë rrobaqepës, pastrues, roje, kopshar, punëtor ndërtimi dhe banakier. Megjithatë dëshira për të punuar vetëm në fushën e tyre arsyetohet si një frikë nga e panjohura dhe mungesa e kompetencave për të punuar në fusha të tjera. Një e dhënë e vlefshme është vullneti dhe gatishmëria për punësim. Një përqindje e madhe (94%) duan të punojnë menjëherë. Një përqindje e papërfillshme (6%) që shprehet se nuk mund të punojë, arsyeton se kjo vjen për shkak të problemeve të rënda shëndetësore. Megjithatë gatishmëria për të punuar shkon përtej, pasi shumica shprehen se mund të punojnë me çfarëdo lloj page dhe nuk vendosin një limit. Përsa i përket punëve që nuk do të donin të bënin, personat me aftësi të kufizuara mendojnë se ka punë që kërkojnë aftësi që ata nuk i kanë dhe për rrjedhojë ata nuk mund t'i bëjnë. Ndërkohë, vihet re se punët e kamerieres apo banakieres nuk janë të preferueshme nga gratë, për shkak të mentalitetit tradicional.

Po kështu të pyetur nëse do ishin të gatshëm të kryenin trajnim para se të punësoheshin shumica (75%) shprehen se nuk kanë nevojë për trajnim, sepse mendojnë se kanë edukimin e duhur për ato punë që kërkojnë të bëjnë. Mungesa e gatishmërisë për t'u trajnuar përbën një barrierë për punësimin e këtyre grupeve. Në fakt kjo vjen për shkak se kjo shtresë është ende e paeksponuar ndaj procesit të trajnimit dhe nuk ka njohuri si mund të realizohet dhe përfitimet që vijnë prej tij. Vetëm 25% janë të gatshëm ta kryejnë trajnimin, me përjashtim të rasteve kur duhet të paguajnë, apo kur duhet të lëvizin në qytete të tjera (sidomos personat me aftësi të kufizuara). Personat që shfaqin një gadishmëri janë kryesisht të rinj, të cilët e shohin të nevojshme sepse u mungon eksperiencia dhe gratë, pasi punët që kërkojnë janë kryesisht zanate të cilat kanë nevojë për një formim profesional, edhe pse ato mund ta kenë por duke pasur një kohë të gjatë të papuna, kanë nevojë për trajnim. Por ata/to theksojnë se nuk mund ta përballojnë financiarisht nëse do iu kërkohej të paguajnë për trajnimin.

## MUNDËSITË PËR PUNËSIMIN E GRUPEVE TË MARXHINALIZUARA NGA NSTË

Një nga pyetjet kërkimore ka të bëjë me rolin dhe ndikimin që kanë NSTë në tregun e punës për grupet e marxhinalizuara duke analizuar dhe eksploruar më shumë mundësitë që ofrojnë NSTë dhe sfidat që ato hasin.

Nga të dhënat primare të marra, vihet re se grupet e marxhinalizuara janë të pa integruar në shoqëri dhe për më tepër në tregun e punës. Siç shihet dhe në dy kategoritë e grupeve të marxhinalizuara si të rinjtë dhe gratë e papuna, për të cilët ka dhe më shumë statistika, pjesëmarrja në forcën e punës është gjithmonë e më shumë në rënie. Kushtet socio-ekonomike të të gjitha kategorive të grupeve të marxhinalizuara të marra në studim janë shumë të vështira dhe vetëm 16% e tyre marrin ndihmë ekonomike. Rezulton se dëshira dhe gatishmëria e tyre për të punuar është e madhe, pavarësisht nëse u duhet të heqin dorë nga ndihma ekonomike që marrin. Pavarësisht se janë ndërmarrë disa masa nga shteti si: programi VET për ti dhënë të rinjve arsim profesional, me qëllim përputhjen e tyre më shumë me nevojat në tregun e punës; programet e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të cilat targetojnë të papunët, të rinjtë, romët dhe egjiptianët, dhe personat me aftësi të kufizuara; Strategjia Kombëtare e Rinisë e hartuar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë që targeton të rinjtë, sërish çështjet e punësimit të grupeve të marxhinalizuara mbeten të paadresuara plotësisht, prandaj fuqizimi i NSve do të kontribuojë në punësimin e këtyre shtresave.

Së fundmi, zhvillimi i NSve është parë veçanërisht edhe nga shteti si një nga mundësitë dhe mekanizmat e përshtatshëm për punësimin e këtyre grupeve. Gjithsesi, kjo mund të shikohet si një mundësi e mirë në të tashmen por jo si një zgjidhje nga ana e shtetit për të larguar të përgjegjësinë e punësimit dhe integritit të grupeve të marxhinalizuara. Realiteti tregon se në vende të ndryshme, modele të tjera të NSve kanë ofruar më shumë vende pune sesa modeli i integritit në punë, për shembull "tipi A" i kooperativave sociale në Itali ka krijuar më shumë vende pune sesa "tipi B" (integriti në punë) i kooperativave sociale.

Ka disa gjetje në këtë studim që tregojnë se NSTë mund të ofrojnë mundësi për integritin e grupeve të marxhinalizuara. Së pari klima e të bërit biznes në Shqipëri është përmirësuar (World Economic Forum, 2015) dhe kjo është një mundësi për NSTë që veprojnë në këtë treg. Është vënë re se NSTë janë një fenomen i ri në treg dhe se janë në fazën e rritjes, ndaj zhvillimi i tyre në të ardhmen përbën një potencial të madh për reduktimin e normës së papunësisë në Shqipëri.

NSTë nëpërmjet misionit të tyre targetojnë disa nga kategoritë e grupeve të marxhinalizuara si të rinjtë dhe gratë e papuna, romët dhe egjiptianët, dhe personat me aftësi të kufizuara dhe po kështu këto janë dhe kategoritë më të përfshira në fuqinë punëtore të NSve. Kjo tregon se këto ndërmarrje sociale kanë një orientim ndaj shërbimit dhe punësimit të tyre. Gjithashtu duke iu referuar nivelit socio-ekonomik, NSTë targetojnë ata me të ardhura të pakta dhe të varfërit, çka i afron më shumë këto ndërmarrje me grupet e marxhinalizuara.

Një tjetër fakt që përbën një mundësi të mirë për punësimin e këtyre





grupeve nga NSTë është veprimtaria e tyre në fusha aktiviteti të ndryshme që nga prodhimet bujqësore, trajnime dhe konsulencë, depozitat/kreditë, tregtia, produktet artizanale, shërbimet e edukimit, produktet ekologjike, shërbimet turistike, veshje/aksesorë, evente kulturore, dhënie me qera, transport mallrash, ushqime dhe shërbime komunitare. Diversiteti i fushës së aktivitetit rrit gamën e mundësive për të punuar në zanate dhe profesione të ndryshme.

Duke qënë se aktiviteti i pjesës më të madhe të NSve është i lidhur ngushtë me misionin (dhe misioni targeton këto grupe), kjo jep premisa për një qëndrueshmëri të aktivitetit të biznesit dhe punësimit të këtyre kategorive. Pavarësisht se vetëm gjysma e NSve zbatojnë inovacion, shumica e bëjnë me qëllim që të rrisin gamën dhe cilësinë e produkteve, çka tregon vizionin e tyre për t'u rritur në treg në mënyrë të konsoliduar.

Përsa i përket premisë për një rritje të qëndrueshme, këtë e fakton dhe rezultati se 60% e këtyre SEve janë pjesë e një grupi, çka krijon një qëndrueshmëri financiare për NSTë. Duke iu referuar totalit të aseteve dhe të ardhurave, mund të thuhet se kapaciteti financiar është i ulët, por ajo çka rrit potencialin e tyre në të ardhmen është se pjesa më e madhe nuk kanë regjistruar humbje vitet e fundit dhe të ardhurat kanë një tendencë rritëse. Këtë e përforcon dhe fakti që pjesa më e madhe e të ardhurave vijnë nga shitjet të subjektet private dhe publike dhe nuk varen vetëm nga grante apo burimet e filantropisë, çka bën dhe diferencën e madhe midis një OJFje dhe NSje përsa i përket strukturës dhe burimeve të të ardhurave. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve sociale përfitojnë nga ndihma jomonetare që është e formave të ndryshme si: ndërtesa, makineri, kompjutera etj, çka i ndihmon NSTë të ulin kryesisht kostot fikse të tyre. Ndhimja të tilla janë thelbësore sidomos për NSTë që janë në fillime të ushtrimit të aktivitetit të tyre, pasi i japin shtysë dhe nxitje rritjes së biznesit.


## **SFIDAT PËR PUNËSIMIN E GRUPEVE TË MARXHINALIZUARA NGA NSTë**

Ka një sërë sfidash që i shoqërojnë NSTë në veprimtarinë e tyre, çka për pasojë e bën të vështirë qëndrueshmërinë financiare dhe hapësirat për punësimin e grupeve të marxhinalizuara.

Së pari, NSTë hasin vështirësi përsa i përket mjedisit ligjor dhe fiskal, pasi mungesa e një kuadri ligjor në lidhje me formalizimin e sipërmarrjeve e bën të vështirë veprimtarinë e tyre në këtë mjedis dhe krijon konfuzion kryesisht në ndërveprimin me autoritetet tatimore. Po kështu fakti që janë të reja në treg përbën përveçse një potencial edhe një sfidë për shkak të mungesës së njohurive dhe eksperiencës.

NSTë kanë mangësi në kapacitetet e brendshme. Ato përballen me vështirësi në rekrutimin e një force të kualifikuar dhe me nivele të larta qarkullimi të stafit. Vetë manaxherët e NSve kanë mungesë të theksuar të aftësive teknike dhe manaxheriale. Kjo ndikon në pamundësi për rritjen e prodhimit dhe përgjigjen në kohë të klientëve.





Sfida shumëfishohet kur mungon ose është e pa zhvilluar ende dhe infrastruktura mbështetëse si: inkubatorët e biznesit, asistenca e specializuar, këshillimi financiar në këtë fushë, hartimi i planeve të biznesit. Po kështu vështirësi hasen dhe me normat e larta të qarkullimit të stafit, por edhe të vullnetarëve, çka përbëjnë kosto shtesë për NSTë.

Një nga problemet kryesore të evidentuara është mungesa e “rrjetëzimit”. Mungesa e lidhjeve dhe pjesëmarrja në rrjete kombëtare por kryesisht ndërkombëtare përbën një dobësi dhe nuk ndikon pozitivisht në çështjet e advokacisë dhe lobimit për një mjedis më mundësues në terma të legjislacionit, sistemi fiskal më të favorshëm, ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave dhe institucioneve mbështetëse.

Siç u argumentua dhe më sipër, një pjesë e konsiderueshme e personave të marxhinalizuar janë të pashkolluar dhe prej shumë vitesh të papunë, gjë që e vështirëson punësimin e tyre dhe e thëllon hendekun e mospërputhjes së kualifikimit të grupeve të marxhinalizuara me tregun e punës. Në këtë pikë është i nevojshëm procesi i trajnimit profesional dhe jo vetëm. Nga studimi rezulton se vetëm gjysma e NSve arrijnë të trajnojnë grupet e marxhinalizuara, dhe kjo vjen për shkak të kapaciteteve të ulëta financiare dhe jo për mungesë vullneti. NSTë që i trajnojnë punonjësit nga grupet e marxhinalizuara por jo vetëm, praktikojnë “trajnimin në punë”, pra në lidhje me punën specifike. Por trajnimi thellohet më shumë në njohuri mbi funksionimin e organizatës, marketingun, shitjet, strukturën e organizatës, politikën, procedurat e brendshme, etj. Nga ana tjetër, për një pjesë të madhe të individëve të intrvitur nga grupet e marxhinalizura, trajnimi nuk shihet si një proces i nevojshëm. Kjo vjen për shkak të mos ekspozimit të tyre ndaj procesit të trajnimit dhe mungesës së njohurive mbi përfitimet që vijnë nga trajnimi.

Pra duhet të bëhet një ndërgjegjësim i përfituesve (grupeve të marxhinalizuara) mbi rëndësinë e trajnimit dhe domosdoshmërinë e tij para integritit të tyre në punë. Gjithashtu, NSTë duhet të investojnë më shumë në fonde për trajnim, qoftë edhe duke gjetur mbështetje nga OJFtë, të cilat mund të ofrojnë trajnime ndaj këtyre grupeve pa kosto ose me kosto të ulët. Por një ndihmesë e madhe do të jepet në qoftë se politikën shtetërore dhe qendrat e formimit profesional do të marrin përsipër trajnimin e grupeve të marxhinalizuara në bashkëpunim me NSTë, çka do nxiste punësimin dhe këta persona do shihen nga NSTë si punonjës potencialë të kualifikuar.



# Kapitulli 6

## Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme bazohen në gjetjet e këtij studimi. Qëllimi i tyre është të ofrojnë sugjerime për qeverinë, politikëbërësit dhe aktorët e tjerë për hartimin e politikave dhe strategjive që do të krijojnë një mjedis mbështetës për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale në Shqipëri dhe rritjen e mundësive të punësimit dhe integrimin e grupeve të marxhinalizuara.

- Shqipëria ka nevojë të ketë një kuadër rregullator në vend lidhur me NSTë. Kuadri do të sigurojë masa mbështetëse dhe politika të nevojshme për zhvillimin e NSve. Aty duhet të përcaktohen karakteristikat, principet drejtuese dhe fusha e aktiviteteve si një kontribut drejt qartësisht të këtij koncepti. Strukturat përfaqësuese të NSve duhet të mundësojnë një dialog të strukturuar me qeverinë, i cili duhet të bazohet në modelin e dialogut me sektorin e biznesit.
- Duke konsideruar që ndërmarrjet sociale janë në fazën fillestare të zhvillimit, Shqipëria duhet të konsiderojë një model legjislativ të hapur më tepër sesa një ligj specifik mbi ndërmarrjet sociale. Kuadri rregullator duhet të adresojë natyrën e qëllimeve dhe aktiviteteve organizative, më shumë sesa thjesht formën institucionale në të cilën mund të vepronë NSTë. Kjo do të mundësojë NSve që të zgjedhin modelin më të mirë të mundshëm bazuar në nevojat e tyre dhe ndjekjen e misionit të tyre social. Parimet mbi atë se çfarë e bën një organizatë ndërmarrje sociale duhet të paraqiten, me qëllim që të shërbejë si mënyrë për dallimin e tyre nga të tjerat.
- Zhvillimi dhe roli i NSve nuk duhet të shihet në mënyrë strikte dhe të kufizohet vetëm te modeli i përfshirjes dhe integritit në punë të grupeve të pafavorizuara. NSTë duhet të shihen në një spektër më të gjerë shërbimesh dhe produktesh, si një mënyrë për të nxitur inovacionin social. Kjo mbështetet edhe nga fakti se NSTë tashmë në treg janë të modeleve

të ndryshme si për nga forma ligjore dhe ajo e pronësisë dhe qeverisjes. Edhe në vende si Finlanda dhe Polonia, ku legjislacioni aktual mbi ndërmarrjet sociale është vetëm i lidhur me integrimin në punë të grupeve të pafavorizuara kanë lindur fusha të reja dhe modele të reja të NSve si psh: ofrimi i shërbimeve komunitare dhe sociale.

- Organizatat e shoqërisë civile, ndërmarrjet sociale, ekspertët dhe qeveria duhet të kenë një rol më aktiv në nxitjen e ndërmarrjeve sociale dhe kontributin e tyre në ekonomi. Bashkëpunimi në rritje me median dhe rrjetëzimi brenda dhe jashtë vendit do të kontribuojë shumë në këtë aspekt.
- Qeveria duhet të krijojë një strukturë përgjegjëse për zhvillimin dhe monitorimin e sektorit të NSve në Shqipëri. OJFtë dhe NSTë duhet të informohen dhe ftohen periodikisht për konsultime me qëllimin hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre.
- Organizatat e shoqërisë civile, institucionet ndërkombëtare, donatorët dhe qeveria duhet të krijojnë programe zhvillimi për të forcuar kapacitetin e NSve dhe po ashtu të krijojnë mundësi për të mësuar rreth modeleve të zhvillimit të biznesit dhe veçanërisht praktikave të suksesshme lokale dhe ndërkombëtare të NSve. Kjo do të shërbejë si një model zhvillimi për NSTë dhe gjithashtu për të advokuar për një mjedis më shumë mundësues ku të veprojnë.
- Qeveria dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të krijojnë programe të përshtatshme trajnimi për grupet e marxhinalizuara, me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës dhe përfshirjen sociale. Programet e trajnimit duhet të përshtaten me nevojat e tyre specifike dhe të marrin në konsideratë papunësimin afatgjatë.
- Qeveria duhet të krijojë grante specifike dhe skema kredish të buta, duke marrë në konsideratë format e NSve dhe grupet e përfutuesve. Kjo ka nevojë të shoqërohet me incentiva të kuptueshme fiskale dhe subvencione për format respektive.
- Qeveria duhet të jetë aktive në sigurimin e asistencës në lidhje me rrjetëzimet, transferimin e teknologjive dhe shërbimeve. Përveç përfitimeve direkte për zhvillimin e NSve, kjo do të ndihmojë dhe në forcimin e bashkëpunimit dhe besimit te institucionet publike, një element i rëndësishëm i demokracisë.
- Ligji i prokurimit publik ka nevojë të rishikojë rregullat e përgjithshme të prokurimit publik me qëllim për ta bërë më të lehtë për NSTë që të marrin pjesë në tendera dhe të fitojnë kontrata publike për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve.
- Qeveria dhe programet e donatorëve duhet të ofrojnë fonde dhe asistencë për të mbështetur sipërmarrësit e rinj. Në vijim, rekomandohet të zhvillohet një dialog proaktiv dhe konstruktiv përmes shkëmbimit të njohurive, aftësive dhe praktikave më të mira rajonale.



# Referenca

- AIDA. (2011). *Innovation Infrastructures Albania*.
- Alter, K. (2007). *Social Enterprise Typology*. Retrieved from <http://www.virtueventures.com/files/setypology.pdf>
- Austin, J., Stevenson, H., & Wei-Skillern, J. (2006). "Social and Commercial Entrepreneurship: Same, Different, or Both?". *Entrepreneurship: Theory & Practice*, 30(1), 1-22.
- Babovic, M., Gjurovaska, M., Hoxha, J., Jankovic, A., Petrivic, T., Rakin, D., et al. (2014). *Strategic Study on Social Economy Development in the Context of the South East Europe 2020 Strategy*. European Movement in Serbia.
- Banka Botërore. (2008). Retrieved from <http://www.worldbank.org/en/country/albania/overview>
- Banka Botërore. (2008). *Microfinance Institutions and Credit Unions in Albania - Regulatory, Supervisory and Market Development Issue*.
- Banka Botërore. (2013). *Banka Botërore*. Retrieved from <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/EXTSOCIALPROTECTION/EXTSF0,,contentMDK:20663797~menuPK:6344572~pagePK:148956~piPK:216618~theSitePK:396378,00.html>
- Banka Botërore. (2015). *ALBANIA World Bank Group Partnership Program Snapshot*.
- BE. (2014). *Projekti BE- IPA 2011 "Mbeshtetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural" (SARD) 2014*. Retrieved from <http://www.ipard-like.al/>
- Borzaga, C., & Galera, G. (2009). *Social enterprise. An international overview of its conceptual evolution and legal implementation*. European Research Institute on Cooperative and Social Enterprises.
- BTI. (2014). *Albania Country Report*. Bertelsmann Stiftung's Transformation Index.
- Dart, R. (2004). *The legitimacy of social enterprise*. *Nonprofit Management and Leadership*, 14(4), 411-424.
- Dees, G. (1998). *The meaning of social entrepreneurship*. Working paper, Kauffman Center for Entrepreneurial Leadership.
- Dees, G. (2011). "The Meaning of "Social Entrepreneurship". Fuqua School of Business, Duke University.
- Defourny, J., & Nyssens, M. (2008). *Social enterprise in Europe: recent trends and developments*. *Social enterprise journal*, 4(3), 202-228.

- Defourny, J., & Nyssens, M. (2010). *Conceptions of Social Enterprise and Social Entrepreneurship in Europe and the United States: Convergences and Divergences*. Journal of Social Entrepreneurship, 1(1), 32 — 53.
- Defourny, J., & Nyssens, M. (2012). *The EMES approach of social enterprises in a comparative perspective*. EMES European Research Network.
- DTI. (2002). *"Social Enterprise. A Strategy for Success"*. London: Department of Trade and Industry,.
- European Union External Action. (2009). Retrieved from [http://eeas.europa.eu/albania/index\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/albania/index_en.htm)
- Evers, A., & Laville, J.-L. (2004). *The Third Sector in Europe*. Edward Elgar Publishing Limited.
- Ferré, C., Galanxhi, E., & Dhono, O. (2015). *Profili i Personave me Aftësi të kufizuar në Shqipëri*. UNITED NATIONS SUPPORT TO SOCIAL INCLUSION IN ALBANIA PROGRAMME.
- Fletorja Zyrtare. (1996). Ligji Nr. 8088/1996 *"Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok"*.
- Fletorja Zyrtare. (2001). Ligji Nr. 8782/2001 *"Për Shoqëritë e Kursim Kreditit"*.
- Fletorja Zyrtare. (2001). Ligji Nr. 8788/2001 *"Për Organizatat Jofitimprurëse"*.
- Fletorja Zyrtare. (2001). Ligji Nr. 8789/2001 *"Për Regjistrimin e Organizative Jofitimprurëse"*.
- Fletorja Zyrtare. (2003). Ligji Nr. 9039/2003 Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr. 8088/1996 *"Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok"*.
- Fletorja Zyrtare. (2007). Ligji Nr. 9039 Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr.8088/1996 *"Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok"*.
- Fletorja Zyrtare. (2007). Ligji Nr. 9814/2007 Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr. 8788, *"Për Organizatat Jofitimprurëse"*.
- Fletorja Zyrtare. (2011). Ligji Nr.10376/2011 Për krijimin e shoqërisë *"Nxjtja e Biznesit Social"*, sh.a.
- Fletorja Zyrtare. (2012). Ligji Nr. 38/2012 *"Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor"*.
- Fletorja Zyrtare. (2013). Ligji Nr. 92/2013 Për disa shtesa dhe amendime në Ligjin Nr. 8788/2001 *"Për Organizatat Jofitimprurëse"*.
- Forbes. (2012). Retrieved from <http://www.forbes.com/sites/lisaquast/2012/11/26/overcome-the-5-main-reasons-people-resist-change/#3ce034c33393>
- Fraisse, L., Lhuillier, V., & Petrella, F. (2007). *Une proposition de typologie des régimes degouvernance à partir des évolutions observées dans les services d'accueil des jeunes enfants en Europe*. EMES European Research Network.
- Gordon, M. (2015). *A Typology of Social Enterprise "Traditions"*. ICEMS, 15-19.



- INSTAT. (2008). *Tregu i Punës 2008*.
- INSTAT. (2011). *Tregu i Punës 2011*.
- INSTAT. (2014). *Prodhimi i Brendshëm Bruto 2014*.
- INSTAT. (2015). *Të Rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë*.
- INSTAT. (2015). *Tregu i Punës 2014*.
- INSTAT. (2016). *Popullsia e Shqipërisë 2015*.
- IPARD. (2014). *Multi-Country Indicative Strategy Paper (2014-2020)*.
- Kerlin, J. (2006). *Social Enterprise in the United States and Europe: Understanding and Learning from the Differences*. International Society for Third-Sector Research, 247-263.
- Këshilli i Ministrave. (2005). Vendimi Nr. 787/2005 *Për Përcaktimin e Kriterëve të Procedurave dhe të Masës së Ndihmës Ekonomike*. Tirana, Albania.
- Këshilli i Ministrave. (2006). Vendimi Nr. 618/2006 *"Për Përcaktimin e Kriterëve, të Dokumentacionit dhe Masës së Përfitimit të Pagesës për Personat me Aftësi të kufizuar"*. Albania: Ministri e Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
- Këshilli i Ministrave. (2008). Vendimi Nr.48/2008 *"Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuarve të papunë nga grupet e veçanta"*.
- Këshilli i Ministrave. (2015). Vendimi Nr. 77/2015 *"Për Kontributet e Detyrueshme dhe Përfitimet nga Sistemi i Sigurimeve Shoqërore dhe Sigurimi i Kujdesit Shëndetësor në Shqipëri"*. 6.
- Këshilli i të Drejtave të Njeriut në Kombet e Bashkuara. (2014). Retrieved from <http://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=14690&LangID=E>
- Këshilli Mbikqyrës i Bankës Botërore. (2005). Vendimi Nr.43/2005 Rregullore *"Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre"*.
- Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë. (2005). Vendim Nr.43/2005 Rregullore *"Për Mbikëqyrjen e Shoqërive të Kursim Kreditit dhe të Unioneve të tyre"*.
- Komisioni European. (2014). *ALBANIA 2014 PROGRESS REPORT*.
- Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. (2014). *Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 "Aftësi më të larta dhe Punë më të Mirë për të Gjitha Femrat dhe Meshkujt"*.
- Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. (2015). *Plani Kombëtar i Veprimt për Rininë 2015-2020*.
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. (2014). *Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020*.
- Nicholls, A. (2006). *Social entrepreneurship, New models of sustainable social change*. Oxford: Oxford University Press.

- Nyssens, M. (2006). *Social enterprise - at the crossroads of market, public policies and civil society*. London: Routledge.
- Nyssens, M., & Defourny, J. (2013). *Social innovation, social economy and social enterprise: what can the European debate tell us?* In *The international handbook on social innovation* (pp. 40-53). Cheltenham, UK: Edward Elgar.
- Partnerët Shqipëri. (2011). *Një Vështrim historik i Zhvillimit të Filantropisë në Shqipëri*.
- Partnerët Shqipëri. (2013). *Zhvillimi i Ndërmarrjeve Sociale*.
- Partnerët Shqipëri. (2014). *Deklarata e Beogradit mbi Zhvillimin e Sipërmarrjes Sociale në Rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë*.
- Schuler, A. (2003). *Overcoming Resistance to Change: Top Ten Reasons for Change Resistance*.
- SEL. (2001). *Introducing Social Enterprise*.
- TACSO Project & ASE Forum. (2013). Research Report "Social Economy in Albania, A Survey on Social Enterprises".
- UNDP. (2008). *Social Enterprise: A new model for poverty reduction and employment generation*. EMES.
- UNDP. (2011). *Raport për grupet vulnerabël në rrezik përjashtimi nga tregu i punës*. Tirane.
- UNDP. (2013). *National Study on Rural Labor Market in Albania*.
- United Nations Human Rights. (2014). *United Nations Human Rights*. Retrieved from <http://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=14690&LangID=E>
- Varga, E., & Villanyi, V. (2011). *Social Enterprise as a Strategy to provide economic opportunities for people with disability in Kosovo*.
- Weisbrod, B. (1975). *Toward a theory of the voluntary nonprofit sector in a three-sector economy*. *Altruism and Economic Theory*, Russell Sage Foundation, (pp. 171-195). New York.
- World Bank. (2013). *World Bank*. Retrieved from <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/EXTSOCIALPROTECTION/EXTSF/0,,contentMDK:20663797~menuPK:6344572~pagePK:148956~piPK:216618~theSitePK:396378,00.html>
- World Economic Forum. (2015). *The Global Competitiveness Report 2014-2015*.
- Yunus, M. (2010). *Building Social Business. Capitalism that can serve humanity's most pressing needs*. Public Affairs.



[www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

